



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 538 Prot.

Tiranë, më 23.05.2025

V E N D I M

Nr. 25, datë 23.05.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR MBIKËQYRJEN E ADMINISTRIMIT TË
SHËRBIMIT CIVIL DHE MONITORIMIN E SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVILË
NË KUSHTET E ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, 11 PRILL – 11 MAJ 2025**

Në bazë të Nenit 11, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (e ndryshuar), dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 11.01.2024, të Komisionerit,

V E N D O S A :

1. Të miratoj Raportin “Për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, 11 Prill – 11 Maj 2025”.
2. Një kopje e Raportit të dërgohet pranë Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Këshillit të Ministrave, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Prezencës së OSBE / ODIHR dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



RAPORT

PËR MBIKËQYRJEN E ADMINISTRIMIT TË
SHËRBIMIT CIVIL DHE MONITORIMIN E
SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVILË NË KUSHTET
E ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË

11 PRILL - 11 MAJ
2025

RAPORT

PËR MBIKËQYRJEN E ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE MONITORIMIN E SJELLJES SË
NËPUNËSVE CIVILË NË KUSHTET E ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

11 PRILL – 11 MAJ 2025

(Miratuar me Vendimin Nr. 25, datë 23.05.2025, të Komisionerit)

Tiranë, Maj 2025

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
KAPITULLI I	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PROCESIT TË MONITORIMIT TË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE SJELLJES SË NËPUNËSIT CIVIL GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE	6
KAPITULLI II	10
PËRGATITJA E PROCESIT TË MONITORIMIT DHE NGRITJA E GRUPEVE TË PUNËS PËR REALIZIMIN E TIJ NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET QË PUNËSOJNË NËPUNËS CIVILË	10
KAPITULLI III	16
MONITORIMI I PREZENCËS NË PUNË DHE SITUATA E EVIDENTUAR SIPAS TË DHËNAVE TË ADMINISTRUARA.....	16
1. Një vështrim mbi subjektet e monitoruara dhe disa të dhëna mbi numrin e nëpunësve civilë të përfshirë në këtë proces	16
2. Situata e konstatuar në lidhje me prezencën në punë të nëpunësve civilë, sipas informacioneve të raportuara nga Grupet e Monitorimit	18
3. Situata e konstatuar në lidhje me administrimin e procesit të mbikëqyrjes së sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore, pas verifikimit në subjekt	26
KAPITULLI IV	30
ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT CIVIL NË LIDHJE ME DISA INSTITUTE TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL TË APLIKUARA GJATË PROCESIT ZGJEDHOR	30
1. Aplikimi i instituteve të ligjit për nëpunësin civil: emërimi në pozicione të shërbimit civil; dorëheqja; pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil; lirimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit (<i>plotësimi i moshës për pension të plotë pleqërie</i>); transferimi në shërbimin civil	30
KAPITULLI V	33
RESPEKTIMI I TË DREJTËS PËR T’U REGJISTRUAR SI KANDIDAT PËR DEPUTET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, SI DHE KOMISIONER NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR	33
KAPITULLI VI	36
VERIFIKIMI I INFORMACIONEVE TË ARDHURA PRANË KOMISIONERIT	36
KAPITULLI VII	43
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET BRENDA VENDIT, PËRFAQËSUES TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARË DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE	43
KAPITULLI VIII	48
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	48

ANEKSI NR. 1

Administrimi i procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore, në sistemin e shërbimit civil dhe ngritja e organeve që ndjekin procesin në subjekt

ANEKSI NR. 2

Situata e prezencës në punë për periudhën 11.04.2025 – 11.05.2025, sipas raportimit të grupeve të monitorimit

HYRJE

Administrata publike përbën themelin e funksionimit të një shteti demokratik dhe garantimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Brenda saj, shërbimi civil zë një rol të veçantë si një strukturë e posaçme që siguron vazhdimësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së shtetit, pavarësisht ndryshimeve politike. Një administratë e qëndrueshme, profesionale, e mbështetur në parimin e meritës, me integritet moral dhe e distancuar nga ndikimet politike, është themelore për ndërtimin e një shteti ligjor dhe besimin e publikut, si dhe një nga kushtet themelore për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Duke pasur parasysh se situata zgjedhore paraqet rrezik të shtuar për shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga ana e institucioneve pjesë e këtij sistemi apo për përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat e organizuara nga subjektet politike, duke cenuar integritetin dhe parimin e paanësisë e neutralitetit të shërbimit civil, Komisioneri, si *watchdog* i zbatimit të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë, praktikë e cila ka nisur me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 dhe ka vijuar në mënyrë të pandërprerë me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në vitin 2019, zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, si dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në vitin 2023. Në përfundim të çdo procesi zgjedhor, monitorimi është finalizuar përmes një raporti përfundimtar, ku janë evidentuar problematikat në administrimin e shërbimit civil dhe janë dhënë rekomandime konkrete për adresimin e tyre.

Faqe | 4

Përgjatë këtyre proceseve, Komisioneri ka administruar dhe shqyrtuar kërkesa të parashtruara nga ana e institucioneve për interpretimin e dispozitave të veçanta të ligjit për nëpunësin civil, duke konstatuar problematika të natyrave të ndryshme dhe duke evidentuar një sërë vështirësish të hasura nga subjektet e ngarkuara me zbatimin e ligjit, kryesisht në lidhje me kuptimin e më tej me zbatimin në praktikë të disa instituteve të ligjit që aktivizohen veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore, siç janë: të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë, pezullimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit, disiplina në shërbimin civil, etj.

Në vijim të kësaj praktike, në planin vjetor të veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për vitin 2025 është përfshirë edhe monitorimi i zbatimit të ligjit gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025.

Baza ligjore mbi të cilën ka vepruar Komisioneri ka qenë ligji nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i vlerësuar në koherencë edhe me rregullimet e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Vendimit të KQZ-së nr. 9, datë 24.12.2020, “*Për rregullat për raportimin e veprimtarisë me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 26.02.2025, “*Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo*

përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”.

Synimi i Komisionerit është që, me anë të këtij procesi, të kontribuojë në ndryshimin e sjelljes së administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, drejt standardeve evropiane; në zbatim të parimeve të administrimit të shërbimit civil; me qëllim që administrata të orientohet drejt zbatimit të detyrave funksionale në shërbim të shtetit dhe publikut dhe jo në ndihmë të subjekteve zgjedhore.

Në kushtet kur tashmë ky proces ka përfunduar, të dhënat në lidhje me hapat e ndërmarrë nga Komisioneri, gjetjet/problematikat e konstatuara apo sfidat kryesore të hasura gjatë zbatimit të ligjit/monitorimit të subjekteve, si dhe konkluzionet/rekomandimet përkatëse për përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave të kontrollit dhe përgjegjësisë, në funksion të përmbushjes së qëllimit të ligjit të përmendur më sipër, do të trajtohen dhe analizohen në mënyrë të përmbledhur në përmbajtjen e këtij raporti.

Faqe| 5

Një kapitull i posaçëm i këtij raporti i dedikohet bashkëpunimit me institucionet që luajnë një rol kyç në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, vendase apo të huaja, të tilla si KQZ dhe OSBE, pa lënë mënjanë edhe shoqërinë civile, si një mekanizëm i jashtëm mbikëqyrës, që ndihmon në rritjen e transparencës dhe evidentimin e shkeljeve eventuale gjatë procesit zgjedhor.

Pjesë integrale e këtij raporti do të jenë edhe Aneksat 1 e 2 bashkëlidhur tij, ku do të pasqyrohen respektivisht të dhënat lidhur me ngritjen e grupeve të monitorimit *(së bashku me aktet përkatëse dhe përbërjen e tyre)*, si dhe të dhënat lidhur me prezencën në punë *(mungesat e justifikuara së bashku me arsyet dhe aktet përkatëse, si dhe mungesat e pajustificuara)*, për secilin institucion pjesë e shërbimit civil përgjatë gjithë periudhës zgjedhore, të kategorizuara sipas tipologjisë së institucioneve.

KAPITULLI I

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PROCESIT TË MONITORIMIT TË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE SJELLJES SË NËPUNËSIT CIVIL GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE

Me qëllim harmonizimin e praktikave administrative në drejtim të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore gjatë fushatës zgjedhore që përkon me periudhën 11 prill - 11 maj 2025, Komisioneri ka hartuar dhe publikuar **Udhëzuesin nr. 15, datë 15.01.2025**, *“Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike dhe detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me ‘Platformat’ apo ‘Rrjetet sociale’ që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën”*, si një instrument i rëndësishëm që synon sqarimin dhe orientimin e institucioneve që përfshihen në sistemin e shërbimit civil, në lidhje me rastet e paqartësive që mund të lindin gjatë kësaj periudhe në raport me sjelljen e nëpunësit civil apo menaxhimin e situatave me risk të lartë për shkelje të ligjit, politizim apo cenim të integritetit dhe paanësisë së administratës në përgjithësi, dhe shërbimit civil në veçanti.

Faqe| 6

Konkretisht, në përmbajtjen e Udhëzuesit janë parashikuar qartësisht metodologjia e monitorimit, rolet e aktorëve përkatës, si dhe janë dhënë orientime në lidhje me:

- **pezullimin** e proceseve të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore;
- **rregullimin** e sjelljes në rrjetet sociale nga nëpunësit civilë;
- **hartimin** e rregullores së brendshme të Grupeve të Monitorimit;
- **kufizimin** e shërbimeve jashtë institucioneve, përjashtuar rastet e domosdoshme;
- **menaxhimin** e lejeve gjatë orarit zyrtar;
- **zbatimin** e dispozitave të vendimit të KQZ-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zyrtarisht, procesi i monitorimit ka nisur me **Urdhrin e Brendshëm nr. 9, datë 14.01.2025**, *“Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie: emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civile gjatë procesit zgjedhor”*, bazuar në nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të cilat sanksionojnë kompetencën e Komisionerit për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë kuadër është vendosur kontakti me **200** institucione të sistemit të shërbimit civil, përkatësisht:

- 110 institucione të administratës shtetërore (12 institucione të administratës shtetërore qendrore: Kryeministria dhe 11 ministritë e linjës, dhe 98 institucione të varësisë),
- 73 institucione të vetëqeverisjes vendore (12 këshilla qarku dhe 61 bashki), dhe
- 17 institucione të pavarura.

Gjatë këtij procesi janë monitoruar **13 671 pozicione pune** pjesë e shërbimit civil.

Në mënyrë të strukturuar, pranë këtyre institucioneve janë ngritur **200 Grupe Monitorimi**, në të cilat janë përfshirë **705 nëpunës civilë**, të kategorive të ndryshme të shërbimit civil dhe në drejtimin e tyre janë caktuar nëpunës civilë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues.

Krijimi i këtyre mekanizmave dhe koordinatorëve në të gjitha institucionet e sipërpërmendura ka kontribuar në rritjen e efektivitetit të komunikimit midis këtyre subjekteve dhe Komisionerit, si dhe në një reagim të shpejtë ndaj problematikave të konstatuara nga Komisioneri apo të sjella në vëmendjen e tij nga ana e institucioneve.

Njëkohësisht, ashtu si dhe në proceset e mëparshme, me qëllim mirëfunksionimin e grupeve të monitorimit dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre gjatë fushatës elektorale, Komisioneri ka luajtur një rol proaktiv, duke i asistuar në mënyrë të vazhdueshme këto subjekte, si dhe duke përgatitur dhe unifikuar aktet në të cilat bazohet veprimtaria e tyre, siç janë: *urdhri* për ngritjen e grupit të monitorimit; *rregullorja e brendshme*, ku janë përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjatë periudhës së monitorimit, si dhe procedura që do të ndiqej për monitorim, nëpërmjet *akt-konstatimeve* dhe raportimit ditor pranë inspektorit të ngarkuar me këtë detyrë.

Në përputhje me planin vjetor të punës - ku është përcaktuar edhe metodologjia e punës gjatë procesit të monitorimit, e cila tashmë është kthyer në një praktikë të konsoliduar - me qëllim njohjen e situatës dhe evidentimin e problematikave, të cilat do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në çdo fazë të procesit, procesi i monitorimit është realizuar nëpërmjet:

- **raportimeve ditore** nga institucionet për emërimet e reja në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, problematikat dhe prezencën në punë të nëpunësve civilë;
- **sondazheve dhe verifikimeve në terren** të kryera nga Komisioneri dhe grupet e tij të mbikëqyrjes;
- **trajtimit të çdo informacioni apo denoncimi**, përfshirë edhe ato të ardhura nga media apo subjekte të treta,

për aspekte të ndryshme të administrimit të shërbimit civil, të tilla si:

- **rekrutimi** në pozicione pune pjesë e shërbimit civil;
- **pezullimi** nga shërbimi civil;
- **disiplina** në punë dhe masat disiplinore;
- **konflikti** i interesit;
- **realizimi** i veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë që në këtë rast kërkojnë zbatimin e disa procedurave të përcaktuara ligjore *(në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre si kandidatë për t'u zgjedhur në organet e qeverisjes vendore e po ashtu, edhe për t'u emëruar në administratën zgjedhore, si anëtarë të KZAZ, KQV dhe GNV)*;
- **të drejtat** politike të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe kufizimet e vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohej pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike, qoftë edhe në rrjetet sociale – aspekt ky ende i parregulluar drejtpërdrejt nga ligji, për të cilin Komisioneri ka shprehur qëndrimin e tij në Udhëzuesin Nr. 15, datë 15.01.2025.

Në kuadër të procesit të monitorimit, Komisioneri ka ushtruar inspektime ditore në terren në **59** subjekte, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara nga Grupet e Monitorimit, si dhe për të evidentuar dhe adresuar probleme që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

Nga të dhënat që kanë arritur pranë Komisionerit, janë evidentuar **4** raste, ku nëpunës civilë janë regjistruar si kandidatë për deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në këto raste, në kuptim të nenit 54, pika “d”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për periudhën e përcaktuar në këtë dispozitë të ligjit, nëpunësit kanë ndërprerë përkohësisht marrëdhënien në shërbimin civil, nëpërmjet institutit të pezullimit nga shërbimi civil. Gjithashtu është evidentuar se në **547** raste, nëpunës civilë kanë marrë pjesë në përbërje të komisioneve të administrimit zgjedhor ku në **201** raste, nëpunës civilë janë emëruar anëtarë të KZAZ-ve; në **257** raste, nëpunës civilë, janë emëruar anëtarë të KQV-ve, në **79** raste, nëpunës civilë, janë emëruar si anëtarë të GNV-ve dhe në **10** raste, nëpunës civilë, janë emëruar si operatorë PIE. Në këto raste, nëpunësit pjesëmarrës në organet zgjedhore kanë dorëzuar pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, kërkesën për pjesëmarrje në to, dhe më tej, secila kërkesë është shoqëruar me Autorizimin e drejtuesit të institucionit për kryerjen e veprimtarisë në këto organe.

Gjatë kësaj periudhe, Komisioneri ka trajtuar **7** raste informacionesh apo denoncimesh të depozituara pranë institucionit, që lidhen me çështje të ndryshme të shërbimit civil, duke ndjekur dhe adresuar zgjidhjen e tyre në bashkëpunim të ngushtë me grupet e monitorimit. Ky përbën një komponent të rëndësishëm të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të Komisionerit, i cili vijon të realizohet rast pas rasti. Këto raste janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në Kapitullin VI “*Verifikimi i informacioneve të ardhura pranë Komisionerit*”, të këtij raporti.

Nga të dhënat e administruara gjatë këtij procesi, janë evidentuar **54** raste të nëpunësve të cilët kanë kryer mungesa të pajustificuara, *(nga të cilat 18 raste i përkasin punonjësve në institucionet e administratës shtetërore dhe 36 raste i përkasin punonjësve të njësive të qeverisjes vendore).*

Kjo shifër konsiderohet e arsyeshme në kuadër të funksionimit të përditshëm të administratës dhe në raport me numrin total të nëpunësve civilë të monitoruar (13 671). Megjithatë, Komisioneri ka kërkuar që edhe këto raste të verifikohen nga njësia e burimeve njerëzore dhe eprori direkt, duke kryer një hetim të plotë për arsyet e mungesës. Në rast të mungesës së pajustificuar, institucionet janë orientuar që të veprojnë sipas legjislacionit përkatës të shërbimit civil, që rregullon institutin e disiplinës në shërbimin civil.

KAPITULLI II

PËRGATITJA E PROCESIT TË MONITORIMIT DHE NGRITJA E GRUPEVE TË PUNËS PËR REALIZIMIN E TIJ NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET QË PUNËSOJNË NËPUNËS CIVILË

Duke qenë se gjatë periudhës së procesit zgjedhor, njësitë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në përmbushje të detyrës së tyre funksionale, do të realizonin një sërë procedurash lidhur me institute të veçanta të ligjit për nëpunësin civil – përmendim këtu rekrutimin në pozicione pune të shërbimit civil; pezullimin nga shërbimi civil; disiplinën në punë dhe masat disiplinore; konfliktin e interesit; pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në veprimtari jashtëfunksionale, si kandidimi për deputet apo përfshirja në komisionet zgjedhore (KZAZ, KQV, GNV); veprimtari të cilat kërkojnë zbatimin e disa procedurave të parashikuara nga ligji; respektimin e të drejtave politike dhe kufizimeve ligjore, sipas nenit 37 të ligjit nr. 152/2013, që ndalon përfshirjen e nëpunësve civilë në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar dhe shprehjen publike të bindjeve politike – Komisioneri kërkoi nga institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të merrnin masa të menjëhershme që, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2025, të monitorojnë veprimtaria dhe sjellja e nëpunësve civilë, në përputhje me ligjin.

Faqe| 10

Procesi i bashkëpunimit është iniciuar me **Udhëzuesin e Komisionerit nr. 15, datë 15.01.2025**, në përmbajtjen e të cilit janë parashtruar sqarime dhe orientime për institucionet, me qëllim **unifikimin e praktikës** lidhur me:

- ecurinë e **procesit të rekrutimit** gjatë periudhës zgjedhore;
- **pjesëmarrjen e nëpunësve civilë** në komisionet/organizmat e ngritura për **administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve**;
- **respektimin e të drejtave politike** të nëpunësve civilë;
- **ndërveprimin e nëpunësve civilë me rrjetet sociale**, në funksion të shmangies së propagandës elektorale;
- si dhe **masat për vendosjen e kontrollit mbi sjelljen** e nëpunësve civilë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Në procesin e monitorimit janë përfshirë të gjitha institucionet që bëjnë pjesë në shërbimin civil, përkatësisht:

- institucionet e administratës shtetërore, përfshirë aparatin e Këshillit të Ministrave, aparatet e ministrive, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrive, si dhe prefekturat e qarqeve;
- institucionet e pavarura ose ato të krijuara me ligj të posaçëm;
- si dhe njësitë e qeverisjes vendore, përkatësisht bashkitë dhe këshillat e qarqeve.

Për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të monitorimit, Komisioneri ka koordinuar veprimtarinë me njësitë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore pranë institucioneve të përfshira, duke kërkuar prej tyre plotësimin e praktikës shkresore për të siguruar dokumentimin e çdo veprimi administrativ të kryer gjatë realizimit të këtij procesi, në funksion të transparencës dhe gjurmueshmërisë institucionale, por edhe të forcimit të llogaridhënies në ushtrimin e funksioneve të administratës gjatë periudhës zgjedhore.

Me qëllim zbatimin e unifikuar të procesit të monitorimit në çdo institucion të përfshirë dhe për të lehtësuar punën e Grupeve të Monitorimit të ngritura pranë këtyre institucioneve, Komisioneri hartoi dhe u vuri në dispozicion të gjitha institucioneve:

- **draft-urdrin e brendshëm për ngritjen e grupit të monitorimit, dhe**
- **draft-rregulloren e veprimtarisë së këtij grupi,**

të cilat shërbyen si instrumente standardizuese për organizimin dhe funksionimin e strukturave të monitorimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit për nëpunësin civil. Këto akte administrative synuan të vendosin një kuadër të qartë procedural dhe të barabartë për të gjitha institucionet, duke rritur efektivitetin e monitorimit dhe duke minimizuar interpretimet e ndryshme gjatë zbatimit në praktikë.

Komisioneri i filloi përgatitjet për monitorimin e këtij procesi në muajin janar 2025, vit i parashikuar për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë.

Për këtë qëllim, me anë të **Urdhrit të Brendshëm nr. 9, datë 14.01.2025**, “*Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie: emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civile gjatë procesit zgjedhor*”, u ngrit struktura e Grupit të Gatshëm, në përbërje të së cilës u përfshinë të gjithë anëtarët e Sekretariatit të Komisionerit.

Ky grup u ngarkua me detyrën për të ndjekur dhe koordinuar procesin e monitorimit, në bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet publike që punësojnë nëpunës civilë, duke siguruar zbatim të drejtë, të njëtrajtshëm dhe në kohë të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

Pavarësisht vullnetit të plotë dhe reagimit të menjëhershëm të institucioneve për të bashkëpunuar me Komisionerin, Grupi i Gatshëm, i ngritur pranë këtij të fundit, ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme grupet e punës të krijuara pranë institucioneve që punësojnë nëpunës civilë. Kjo asistencë është ofruar kryesisht në lidhje me veprimet administrative dhe përgatitjen e materialeve shkresore, të nevojshme për adresimin dhe menaxhimin e situatave specifike të hasura gjatë zhvillimit të procesit të monitorimit. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente dhe çdo akt i prodhuar në këtë kuadër është bërë publik në faqen zyrtare të Komisionerit.

Përbërja e grupeve të punës pranë institucioneve u kërkuar të ndërtohej në përputhje me karakteristikat strukturore dhe organizative të secilit institucion, duke u bazuar në numrin e nëpunësve civilë për t'u monitoruar dhe shtrirjen territoriale të institucioneve. Në këto grupe u kërkuar në mënyrë të detyrueshme, pjesëmarrja e drejtuesve të njësive përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të cilëve iu caktua një rol thelbësor në realizimin efektiv të procesit të monitorimit. Gjithashtu, u kërkuar që një prej anëtarëve të grupit të emërohej si koordinator, me detyrë mbajtjen e kontaktit të drejtpërdrejtë me Grupin e Gatshëm dhe palët e tjera të interesuara.

Objekti i veprimtarisë së këtij grupi u përcaktua sjellja e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, me fokus të respektimi i detyrave të tyre funksionale, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe zbatimi i disiplinës formale në punë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për shërbimin civil.

Grupi i Monitorimit u udhëzua të vepronte në bashkëpunim të ngushtë me eprorët direkt të nëpunësve civilë, si dhe me njësinë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore, me qëllim që të sigurohej respektimi i diskrecionit ligjor të këtyre subjekteve, në përputhje me kompetencat që u njihen në mënyrë të qartë nga ligji.

Realizimi me sukses i objektivit të këtij grupi u orientua nga Komisioneri, nëpërmjet përcaktimit të aspekteve thelbësore dhe detyrimeve, të cilat duhej të zbatoheshin nga të gjithë nëpunësit civilë të institucionit gjatë periudhës së monitorimit. Këto detyrime, të cilat kishin për qëllim të garantonin disiplinën administrative, transparencën, dhe mospërfshirjen në veprimtari politike në kundërshtim me ligjin, duke mbrojtur integritetin e shërbimit civil në funksion të interesit publik, janë si më poshtë:

- Në një regjistër të posaçëm, i cili do të administrohet nga Grupi i Monitorimit, nëpunësit civilë duhet të shënojnë çdo ditë hyrje - daljet në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08.00 që fillon orari ditor i punës deri në orën 16:30/14:00 ditën e premte, apo në përputhje me orarin e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.
- Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të shënohen në orën 8:00, të gjithë nëpunësit civilë që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.
- Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listëprezenca e nëpunësve civilë do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.
- Nëpunësit duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e

telefonit, pranë njësisë së burimeve njerëzore.

- **Eprorët** direkt duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mospasja dijeni për mungesa të stafit, do të konsiderohet si mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.
- **Gjatë** orarit zyrtar 8:00 deri 16:30/14:00 ditën e premte (ose orari i përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit), nëpunësit civilë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.
- **Nëpunësi** civil nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët, të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit, të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit.
- **Nëpunësi** civil të informojë grupin e monitorimit në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

- **Pas** orarit ditor të punës, nëpunësi civil nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.
- **Grupi** i Monitorimit do të organizojë kontrole në frekuenca të shpeshta gjatë orarit ditor të punës, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit prezent në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.
- **Grupi** i Monitorimit, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga ky grup, do të komunikojë çdo ditë me personin e kontaktit, pjesë e Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.
- **Grupi** i Monitorimit do të ndjekë me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civil në kundërshtim me ligjin.

Tabela nr. 1: Pjesëmarrja e nëpunësve civilë në Grupet e Monitorimit

INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË MONITORIM	PUNONJËSIT QË KANË MARRË PJESE NË GRUPET E MONITORIMIT
ADMINISTRATA SHTETËRORE (1)	

Aparati i Këshillit të Ministrave + aparati i ministrive + institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit / ministrive + Prefekti i Qarkut	397
NJËSITË E QEVERISJES VENDORE (2)	
Bashkitë + Këshillat e Qarkut	249
INSTITUCIONET E PAVARURA (3)	
Institucionet e pavarura	59
TOTALI	705

Në bazë të të dhënave të raportuara nga institucionet, rezulton se të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil kanë miratuar, në përputhje me orientimet e Komisionerit, Urdhrin “Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Grupit të Monitorimit. Këto akte janë dërguar pranë Komisionerit, si në rrugë elektronike (me e-mail), ashtu edhe me shkresë zyrtare.

I gjithë procesi që ka lidhje me ngritjen e Grupeve të Monitorimit pasqyrohet në **ANEKSIN NR. 1** të këtij raporti vlerësimi, nën titullin: “Administrimi i procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore, në sistemin e shërbimit civil dhe ngritja e organeve që ndjekin procesin në subjekt”, ku paraqitet përbërja e këtyre mekanizmave dhe akti i krijimit të tyre.

Grupi i Monitorimit, i ngritur në secilin institucion, ka qenë organi përgjegjës për verifikimin e prezencës në punë të nëpunësve civilë gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore, konkretisht nga data 11.04.2025 deri më 11.05.2025.

Veprimtaria e grupeve të monitorimit është dokumentuar përmes akt-konstatimeve ditore, të cilat janë dërguar edhe pranë Komisionerit, në të cilat është pasqyruar në mënyrë të detajuar çdo hyrje dhe dalje e punonjësve, si dhe lëvizjet e tyre gjatë ditës së punës dhe rezultatet janë të pasqyruara në **ANEKSIN NR. 2** të raportit të vlerësimit, nën titullin “Situata e prezencës në punë për periudhën 11.04.2025 – 11.05.2025, sipas raportimit të Grupeve të Monitorimit”, ku evidentohen 19 ditë pune të mbikëqyrura për çdo institucion.

Në përfundim, zbatimi i këtij mekanizmi të posaçëm monitorimi, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet që punësojnë nëpunës civilë, garantoj një proces të unifikuar, të strukturuar dhe të bazuar në ligj për mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore. Angazhimi i vazhdueshëm i Komisionerit dhe respektimi i detyrimeve institucionale nga ana e

njësive përkatëse kontribui në ruajtjen e integritetit të shërbimit civil dhe sigurimin e paanësisë së tij gjatë një periudhe me rëndësi të veçantë për funksionimin demokratik të shtetit.

KAPITULLI III

MONITORIMI I PREZENCËS NË PUNË DHE SITUATA E EVIDENTUAR SIPAS TË DHËNAVE TË ADMINISTRUARA

Kjo pjesë e raportit fokusohet në analizën e detajuar të monitorimit të prezencës në punë të nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore, duke u mbështetur në të dhënat e administruara dhe të përpunuara nga Sekretariati i Komisionerit. Për të krijuar një pamje të qartë dhe të plotë mbi sjelljen e nëpunësve civilë në drejtim të respektimit të rregullave të vendosura për të disiplinuar sjelljen e nëpunësve civilë përgjatë periudhës së monitoruar, në vijim do të paraqiten të dhëna mbi institucionet dhe numrin e nëpunësve civilë të monitoruar, rezultatet kryesore lidhur me pranimin e tyre në punë gjatë orarit zyrtar, si dhe situatat e ndryshme të mungesave, duke evidentuar prezencën, mungesat e justifikuara dhe ato të pajustificuara.

Faqe| 16

1. Një vështrim mbi subjektet e monitoruara dhe disa të dhëna mbi numrin e nëpunësve civilë të përfshirë në këtë proces

Procesi i monitorimit të zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil, si dhe i sjelljes dhe veprimtarisë së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2025, është shtrirë pothuajse në të gjitha institucionet që bëjnë pjesë në sistemin e shërbimit civil.

Pas miratimit të Urdhrit për ngritjen e Grupeve të Monitorimit nga titullari i secilit institucion dhe Rregullores së Brendshme të funksionimit, institucionet kanë filluar zbatimin aktiv të detyrimeve që rrjedhin prej tyre që me fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, në datën 11.04.2025. Në këtë kuadër, ato kanë nisur të raportojnë në mënyrë të rregullt pranë Komisionerit mbi sjelljen e nëpunësve civilë, përfshirë edhe çdo problematikë të konstatuar gjatë procesit të monitorimit, në lidhje me çdo institut të ligjit, si dhe veprimet e ndërmarra për adresimin e tyre.


Me përmbylljen e fazës përgatitore dhe krijimin e bazës ligjore dhe procedurale për funksionimin e mekanizmit të monitorimit, Komisioneri ka kaluar në fazën tjetër të procesit, duke komunikuar në mënyrë të vazhdueshme/periodike dhe duke zhvilluar një bashkërendim të drejtpërdrejtë me grupet e monitorimit pranë institucioneve. Kjo është realizuar përmes ndjekjes së përditshme të situatës, nga ana e inspektorëve të Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit, për të qenë koherent me çdo zhvillim dhe për të garantuar respektimin e ligjshmërisë dhe standardeve të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

Në kuadër të zbatimit të detyrave që lidhen me procesin që po analizojmë, Komisioneri përcaktoi detyrimin që Grupet e Monitorimit të raportojnë në baza ditore të dhënat përkatëse pranë stafit të ngarkuar me ndjekjen e ecurisë së tij. Raportimi është realizuar në rrugë elektronike ose përmes postës zyrtare, nëpërmjet dokumentit të akt-konstatimit, në të cilin pasqyrohet gjendja faktike e prezencës në punë të punonjësve të institucionit dhe çdo aspekt tjetër i administrimit të shërbimit civil.


Për të siguruar një standard të unifikuar të raportimit dhe për të lehtësuar përpunimin dhe analizën e të dhënave mbi problematikat e mundshme, Komisioneri hartoi një format të standardizuar të akt-konstatimit, me rubrika dhe indikatorë të përcaktuar qartë, të cilët u shpërndanë pranë të gjitha institucioneve të përfshira në proces. Ky dokument standard u mirëprit nga subjektet në monitorim, të cilat iu përgjigjën me korrektesë dhe në kohë kërkesave të përcaktuara në të.

Rezultoi se grupet e monitorimit e ushtruan funksionin e tyre në përputhje me udhëzimet e Komisionerit, duke administruar një regjistrë të veçantë të prezencës së punonjësve, të hartuar sipas modelit zyrtar të dërguar. Monitorimi u realizua nëpërmjet disa sondazheve ditore të prezencës në punë të punonjësve, ndër të cilat përfshiheshin dy regjistrime të detyrueshme – në fillim dhe në përfundim të orarit zyrtar të punës – si dhe të tjera, të shpërndara në mënyrë të rastësishme gjatë ditës, me qëllim vlerësimin sa më real të respektimit të këtij orari nga ana personelit administrativ.


Në përfundim të procesit të monitorimit të zhvilluar gjatë periudhës zgjedhore, Komisioneri raporton për përfshirjen e gjithsej **200** institucioneve pjesë e shërbimit civil, të ndara sipas tipologjisë së mëposhtme:



institucione të administratës shtetërore, të cilat përfaqësojnë strukturat që veprojnë në nivelin qendror të administratës publike (*Kryeministria dhe ministrinë e linjës*) së bashku me institucionet në varësi të tyre;



njësi të qeverisjes vendore (*NJQV*), ku bëjnë pjesë 61 bashki dhe 12 këshilla qarku;



institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm.

Lista e plotë e këtyre institucioneve, është paraqitur në Aneksat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij raporti.

Në përputhje me strukturën organizative të secilit prej këtyre institucioneve, është bërë evidentimi i numrit të nëpunësve civilë të monitoruar në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë periudhës zgjedhore që po analizohet. Të dhënat përkatëse mbi shpërndarjen numerike të nëpunësve sipas tipologjisë institucionale janë pasqyruar në tabelën në vijim dhe shërbejnë si bazë për analizën që do të pasojë.

Tabela nr. 2: Numri i nëpunësve civilë të monitoruar për periudhën 11 prill – 11 maj 2025, sipas tipologjisë së institucioneve

(1)	(2)	(3)	(4)
Administrata shtetërore <i>(Aparati i Këshillit të Ministrave + aparati i ministrive + institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrive + Prefekti i Qarkut)</i>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore <i>(61 Bashki + 12 Këshilla Qarku)</i>	Institucione të pavarura <i>(17 institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm)</i>	TOTALI <i>(Nëpunës civilë të mbikëqyrur)</i> Shuma 1+2+3
7 097	5 599	975	13 671

Sipas të dhënave statistikore të përpunuara nga Sekretariati i Komisionerit, rezulton se janë mbikëqyrur **13 671** nëpunës civilë, të cilët janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike nga Grupet e Monitorimit, mesatarisht 3 herë në ditë, përgjatë 19 ditëve, duke nisur nga data 11 prill deri më 11 maj 2025. Datat 21 prill dhe 1 maj kanë përkuar me ditë festash zyrtare dhe, si rrjedhojë, nuk janë përfshirë në periudhën e monitorimit.

Faqe| 18

Referuar të dhënave të dërguara nga Grupet e Monitorimit dhe të përpunuara nga Sekretariati i Komisionerit, vlerësojmë nivelin e lartë të bashkëpunimit institucional me subjektet e përfshira në procesin e mbikëqyrjes, të cilat kanë treguar një gatishmëri të plotë për të raportuar dhe për të informuar Komisionerin për çdo të dhënë të kërkuar në lidhje me proceset e monitoruara.

2. Situata e konstatuar në lidhje me prezencën në punë të nëpunësve civilë, sipas informacioneve të raportuara nga Grupet e Monitorimit

Ashtu siç është paraqitur në pjesën analitike të këtij raportimi, grupet e monitorimit të ngritura pranë çdo institucioni kanë monitoruar zbatimin e disiplinës në punë lidhur me prezencën fizike të nëpunësve civilë gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025. Të dhënat janë mbledhur në mënyrë të përditshme dhe janë përcjellë në kohë reale pranë Sekretariatit të Komisionerit, përmes formatit zyrtar të akt-konstatimit.

Në vijim, Sekretariati i Komisionerit ka realizuar përpunimin e të gjitha të dhënave të dërguara për çdo ditë pune dhe ka përgatitur një pasqyrë të përgjithshme të ecures së procesit, e cila mbulon periudhën nga data 11 prill deri më 11 maj 2025, përkatësisht 19 ditë pune efektive, duke përfshirë ditët e festave zyrtare (21 prill dhe 1 maj).

Të dhënat e grumbulluara përfshijnë disa aspekte të rëndësishme të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, ndër të cilat përmendim:

- **Respektimi** i orarit zyrtar të punës dhe prezenca fizike në vendin e punës;
- **Përfshirja** e nëpunësve civilë në komisionet e administrimit

zgjedhor, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse;

- Rastet e regjistrimit të nëpunësve civilë si kandidatë për deputetë në

Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me të drejtën e tyre për t'u zgjedhur.

Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim të këtij raporti, me qëllim formulimin e konkluzioneve objektive dhe gjithëpërfshirëse mbi respektimin e parimeve të shërbimit civil, si dhe të të drejtave politike të nëpunësve civilë gjatë kësaj periudhe të veçantë.

Ashtu siç është evidentuar edhe më sipër, nëpërmjet grupeve të monitorimit është realizuar një raportim i përditshëm pranë Sekretariatit të Komisionerit, gjatë fushatës për zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025.

Faqe| 19

Në përfundim të këtij procesi, rezulton se janë monitoruar gjithsej **13 671** nëpunës civilë, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre në **200** institucione.

Në funksion të këtij procesi, janë mbledhur dhe përpunuar të dhënat që lidhen me prezencën fizike të nëpunësve në vendin e tyre të punës gjatë orarit zyrtar, në momentin e kryerjes së sondazheve nga grupet e monitorimit. Në këtë kuadër, janë evidentuar raste kur nëpunësit civilë nuk janë gjetur në vendin e punës në momentin e sondazhit, të cilat janë kategorizuar si:

- **Mungesa të justifikuara**, për të cilat institucionet përkatëse kanë përcjellë së bashku me akt-konstatimin edhe materialet mbështetëse shkresore, të cilat dokumentojnë shkakun e mungesës;
- **Mungesa të pajustificuara**, kur nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që vërteton arsye të ligjshme për mosprezencën në punë.

Rastet e mungesave të justifikuara dhe arsyet përkatëse janë të evidentuara në ANEKSIN Nr.2 bashkëlidhur këtij raporti.

Sa i takon **mungesave të pajustificuara**, si një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e respektimit të disiplinës së punës dhe integritetit institucional gjatë një periudhe zgjedhore delikate, ku pavarësia dhe neutraliteti i nëpunësit civil merr një rëndësi të veçantë, rezulton se nga grupet e monitorimit janë raportuar **54** raste të nëpunësve të cilët kanë kryer mungesa të pajustificuara, (nga të cilat **18** raste i përkasin punonjësve në institucionet e administratës shtetërore dhe **36** raste i përkasin punonjësve të njësisë të qeverisjes vendore).

Krahasimisht me të dhënat e pasqyruara në Aneksin nr. 2, kjo shifër vlerësohet si e arsyeshme në normalitetin e punës së përditshme të administratës, megjithatë, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet që edhe këto raste të verifikohen nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në bashkëpunim me eprorin direkt të nëpunësit përkatës, të kryhet një hetim i plotë mbi arsyen e mosparaqitjes në punë të punonjësit dhe nëse arrihet në konkluzionin se mungesa e nëpunësit

përkatës është e pajustificuar, të veprohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil të parashikuar në kreun X “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Konkretisht, sipas të dhënave të administruara gjatë monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë në lidhje me prezencën në punë gjatë fushatës zgjedhore, konstatohet se, mosprezenca e pajustificuar në punë e nëpunësve civilë është konstatuar në institucionet e paraqitura në vijim, për punonjësit e evidentuar në secilin prej tyre, sipas tipologjisë së institucioneve:

▲ PËR INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE:

✍ Në institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes

Faqe| 20

Referuar akt-konstatimeve, si dhe dokumentacionit plotësues sqarues të dërguar nga grupi i monitorimit të ngritur pranë këtij institucioni është konstatuar se nuk janë paraqitur në punë, në mënyrë të pajustificuar, për datat e evidentuara më poshtë, punonjësit:

- ***** , me detyrë “*Specialiste*”, në Sektorin e Politikës së Sigurisë Europiane, Drejtoria e Politikave NATO dhe BE, joprezent në datat 11.04.2025 – 09.05.2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Projekteve dhe Pajisjeve Ushtarake, Drejtoria e Modernizimit, joprezent në datat 15 – 28 prill 2025 dhe 5 – 8 maj 2025.

Për verifikimin e këtyre rasteve u kërkuar informacion nga grupi i monitorimit i ngritur pranë institucionit. Në përgjigje të kësaj kërke, ky i fundit sqaroi se, kjo problematikë është evidentuar nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe për këto raste është njoftuar njësia përgjegjëse, DAP.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionerit nga grupi i monitorimit, referuar listëprezencës për muajin prill 2025, u konstatua se, nëpunësja ***** , si gjyqfituese është sistemuar në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, si “*Specialiste*”, në Sektorin e Politikës së Sigurisë Europiane, Drejtoria e Politikave NATO dhe BE, në institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes, por nuk është paraqitur në punë dhe si rrjedhojë nuk është paguar asnjë ditë. Pra, për këtë nëpunëse marrëdhëniet financiare me institucionin nuk kanë filluar.

Ndërsa për nëpunësin ***** , me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Projekteve dhe Pajisjeve Ushtarake, njësia e burimeve njerëzore pranë institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes, me e-mailin e datës 19.05.2025, ka informuar Komisionerin se, pas komunikimit me eprorin e drejtpërdrejtë të nëpunësit rezulton se, nëpunësi ka kërkuar leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, vizita mjekësore për shkak të nevojës emergjente për kryerjen e një ndërhyrjeje kirurgjikale, por nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues.

Sa i takon rasteve të mungesave të pajustificuara, Komisioneri përmes grupit të monitorimit, i ka kërkuar institucionit të kryejë një hetim të plotë lidhur me arsyen e mosparaqitjes në punë

të nëpunësit, duke e materializuar në fund procesin e hetimit me fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësit, në rast se konstatohet mungesa e pajustificuar e tij në punë, në përputhje me kërkesat e institutit të disiplinës në shërbimin civil.

✓ Në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë

Për periudhën e monitorimit, në këtë institucion varësie është konstatuar vetëm **1** rast mungese të pajustificuar në datën 09.05.2025. Bëhet fjalë për nëpunësen *****, me detyrë “Drejtor”, Drejtoria e Analizës dhe Monitorimit, në këtë institucion.

Në lidhje me këtë rast, pas verifikimit të kryer nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, nëpunëses nuk i është paguar dita e punës.

Faqe| 21

✓ Në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Sipas të dhënave të raportuara në akt-konstatimet e dërguara nga grupi i monitorimit të ngritur në këtë institucion është konstatuar se, ka pasur në **12** raste mungesa të pajustificuara të nëpunësve gjatë monitorimit të prezencës së tyre në vendin e punës. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Dibër, joprezent në datën 02.05.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Dibër, joprezent në datën 07.05.2025;
- *****, me detyrë “Specialist”, Sektori i Shërbimit Tatimpagues, DRT Dibër, joprezent në datën 09.05.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, DRT Tiranë joprezent në datën 11.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit në Vend, DRT Tiranë joprezent në datën 11.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, DRT Tiranë joprezent në datat 11.04.2025, 16.04.2025 dhe 17.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, DRT Tiranë joprezent në datat 14.04.2025 dhe 29.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, DRT Tiranë joprezent në datat 14.04.2025 dhe 16.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit në Vend, DRT Tiranë joprezent në datat 11.04.2025, 14.04.2025 dhe 15.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, DRT Tiranë joprezent në datën 18.04.2025;
- *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, joprezent në datën 05.05.2025;

- *****, me detyrë “Inspektor”, Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese, joprezent në datat 05.05.2025 dhe 09.05.2025.

Në vijim, pas verifikimit të kryer nga grupet e monitorimit në bashkëpunim me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, për të gjithë nëpunësit është dhënë masa administrative “*heqje e ditës së punës*”.

✓ Në institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit

Gjatë verifikimeve të akt-konstatimeve të dërguara nga grupi i monitorimit ka rezultuar se, në këtë institucion nëpunësja *****, me detyrë “*Specialiste*” në Sektorin e Regjistrimit, ka munguar në punë në datën 24.04.2025 dhe nëpunësja *****, me detyrë “*Specialiste*” në Sektorin e Asistencës për Aplikimin Online mbi Regjistrimin e Biznesit, Lejeve dhe Licensave dhe Pronarit Përfitues, ka munguar në datën 25.04.2025, duke mos paraqitur dokumentacion justifikues. Për këtë arsye, grupi i monitorimit i ka cilësuar si mungesa të pajustificuara. Referuar këtij konstatimi, për të dy nëpunëset është vendosur si masë administrative: “*heqja e ditës së punës*” për datat respektive.

✓ Në institucionin e Prefekti Lezhë

Në vijim të komunikimit në lidhje me sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor, në akt-konstatimet mbi prezencën në punë, grupi i monitorimit i ngritur në institucion ka bërë shënimin “*Joprezent*” në datat 6 - 9 maj 2025, për nëpunësen *****, me detyrë “*Specialist Arkiv/Protokolli*”, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në institucionin Prefekti Lezhë.

Në këtë rast, Komisioneri ka kërkuar nga institucioni që të kryhet një hetim i plotë nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe eprori direkt i nëpunëses mbi arsyen e mosparaqitjes në punë të punonjëses. Në rast se, konstatohet mungesa e pajustificuar është dhënë orientimi që të vijohet më tej, me aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke informuar Komisionerin për veprimet e kryera.

▲ PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE:

✓ Në institucionin e Bashkisë Lezhë

Referuar prezencës në punë, të pasqyruar në akt-konstatimet e mbajtura nga grupi i monitorimit të ngritur pranë Bashkisë Lezhë, për nëpunësin *****, me detyrë “*Specialist Veterinar*”, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar e Ushqimor, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, janë raportuar në tre ditë mungesa të pjesshme gjatë ditës së punës, në orare të ndryshme dhe bëhet fjalë për datën 02.05.2025, ku nuk ka qenë prezent në punë në orën 11:30 dhe orën 14:00; datën 05.05.2025, ku nuk ka qenë prezent në orën 8:00 dhe akt-konstatimin e datës 06.05.2025, ku nuk ka qenë prezent në orën 16:00.

Në lidhje me këtë rast, nëpërmjet shkresës nr. 5582 prot., datë 07.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Lezhë, nëpunësi ***** është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, për të diskutuar në lidhje me arsyen e mosprezencës së tij në oraret e evidentuara në akt-konstatimet.

Në procesverbalin e mbajtur gjatë seancës dëgjimore me nr. 5582/1 prot., datë 19.05.2025, nëpunësi ***** ka theksuar se mungesa gjatë ditës së punës, në orare të ndryshme ka ardhur si pasojë e disa problemeve personale, familjare dhe jo për shkaqe të lidhura me procesin zgjedhor.

Në vijim, nëpërmjet e-mailit të datës 20.05.2025, Bashkia Lezhë ka njoftuar Komisionerin se, pas realizimit të seancës dëgjimore në datën 19.05.2025, ora 14:00, në ngarkim të nëpunësit civil ***** , me urdhrin nr. 245, datë 20.05.2025, të Kryetarit të Bashkisë, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

✓ Në institucionin e Bashkisë Pukë

Në këtë institucion është konstatuar se, **ka pasur 6 raste të mungesave të pajustificuara**. Bëhet fjalë për punonjësit e evidentuar më poshtë:

- ***** , me detyrë “*Specialist Arsimi*”, joprezent në datat 15 – 18 prill 2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist Kulture*”, joprezent në datat 15 – 17 prill 2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist Turizmi*”, joprezent në datat 14 dhe 15 prill 2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist i Emergjencave Civile*”, joprezent në datën 15 prill 2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist/Inxhinier*”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, joprezent në datën 23.04.2025;
- ***** , me detyrë “*Specialist/Jurist*”, në Sektorin e Prokurimeve Publike dhe Çështjeve Juridike, joprezent në datën 23.04.2025.

Pas verifikimit të arsyes së mungesës në vendin e punës, nga ana e institucionit për këta punonjës është vendosur “*heqja e ditës së punës*”. Ndërsa për punonjësin ***** nuk është marrë masë pasi nga verifikimi i kryer nga grupi i monitorimit dhe eprori direkt i nëpunësit ka rezultuar se ka qenë i ngarkuar me punë në terren në zbatim të urdhrit të zv/kryetarit të bashkisë.

✓ Në institucionin e Bashkisë Divjakë

Në mbështetje të akt-konstatimeve si dhe akteve plotësuese sqaruese, të dërguara nga koordinatori, është konstatuar në **1** rast mungesë e pajustificuar. Bëhet fjalë për nëpunësin ***** , me detyrë “*Drejtor i Bujqësisë, Mjedisit, Veterinarisë dhe Pyjeve*”, në këtë institucion, për të cilin njësia e burimeve njerëzore ka raportuar se është vendosur heqja e ditëve të punës për të gjithë periudhën e monitoruar (11.04.2025 – 09.05.2025). Gjithashtu është

njoftuar eprori direkt i këtij nëpunësi për të shqyrtuar nëse ekzistojnë rrethanat për nisjen e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.

Gjithashtu, për nëpunësin *****, me detyrë “*Specialist Veteriner*”, në Njësinë Administrative Tërbuf, në datën 17.04.2025 dhe datën 23.04.2025 janë konstatuar mungesa të pajustificuara.

Sipas raportimit në e-mailin e datës 19.05.2025, nga Bashkia Divjakë, pas verifikimit të kryer rezulton se, nëpunësi ka qenë prezent në punë, i ngarkuar me kryerjen e detyrës në terren; mosfirmosja e prezencës ka qenë pasojë e angazhimit të tij në detyrë.

✓ Në institucionin e Bashkisë Fier

Sipas akt-konstatimeve si dhe akteve plotësuese sqaruese, të dërguara nga grupi i monitorimit, është konstatuar se, nëpunësi *****, me detyrë “*Specialist për Integrimin European dhe Investimet e huaja*”, në datën 11.04.2025, nuk ka qenë prezent në punë dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në këtë rast ka vendosur si masë administrative “*heqjen e ditës së punës*”, për mungesën e pajustificuar.

✓ Në institucionin e Bashkisë Mallakastër

Në akt-konstatimet e dërguara nga grupi i monitorimit të ngritur pranë Bashkisë Mallakastër, është konstatuar se, nëpunësi *****, me detyrë “*Përgjegjës Auditit*”, nuk ka nënshkruar prezencën në disa akte, sipas raportimit të institucionit. Kjo ka ndodhur për shkak se, me urdhrin e brendshëm nr. 42 (503 prot.), datë 03.02.2025, është komanduar për kryerjen e Auditimit të Brendshëm, dhe si rrjedhojë paraqitet në vendin e punës vetëm 3 herë në javë.

✓ Në institucionin e Bashkisë Roskovec

Referuar akt-konstatimeve të dërguara nga koordinatori pranë kësaj bashkie, është konstatuar se, në datën 02.05.2025, nëpunësja *****, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm*”, nuk ka nënshkruar në akt-konstatim, pasi nuk është paraqitur në punë.

Pas njoftimit të eprorit të nëpunëses, ky i fundit ka nisur procedimin disiplinor në ngarkim të punonjësës *****, në përfundim të së cilit është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje*”, me vendimin nr. 108, datë 13.05.2025, “*Për dhënien e masës disiplinore Vërejtje*”, të kryetarit të bashkisë. Gjithashtu, me e-mailin e datës 19.05.2025, njësia e burimeve njerëzore e kësaj bashkie ka raportuar se, për nëpunësen në fjalë është marrë si masë administrative: “*heqje e ditës së punës*”, për datën 02.05.2025.

✍ Në institucionin e Bashkisë Krujë

Në këtë institucion për periudhën e monitorimit është konstatuar mungesa në punë, e pajustificuar, në datën 07.05.2025, e nëpunëses *****, me detyrë “*Specialiste e Pronave*”. Për këtë arsye, është vendosur “*heqja e ditës së punës*”, për nëpunësen.

✍ Në institucionin e Bashkisë Vlorë

Nga verifikimet e akt-konstatimeve të dërguara nga koordinatori, rezultoi se, në datën 17.04.2025, punonjësja *****, me detyrë “*Specialiste/Juriste*” nuk ka nënshkruar në akt-konstatimet e monitorimit ditor, e për këtë arsye, si dhe duke mos patur asnjë element tjetër justifikues, grupi i monitorimit e ka konsideruar si mungesë të pajustificuar. Në vijim institucioni ka vepruar me dhënien e masës administrative “*heqje e ditës së punës*”, për nëpunësen.

Faqe| 25

✍ Në institucionin e Bashkisë Pogradec

Referuar prezencës në akt-konstatimet e dërguara nga grupi i monitorimit të ngritur pranë Bashkisë Pogradec, konstatohet se, janë evidentuar në 2 raste, mungesa të pajustificuara, të nëpunësve të raportuar për këtë institucion, për të cilët është vendosur marrja e masës administrative “*heqje e ditës së punës*”. Bëhet fjalë për punonjësit:

- *****, me detyrë “*Specialist për prokurimet publike*”, joprezent në datat 11, 17 dhe 18 prill 2025;
- *****, me detyrë “*Specialist për Monitorimin dhe Zbatimin e Kushteve të Kontratës dhe Lejeve të Ndërtimit*”, joprezent në datën 11.04.2025.

✍ Në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë

Në vijim të komunikimit në lidhje me sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor, në akt-konstatimet mbi prezencën në punë, grupi i monitorimit pranë Bashkisë Rrogozhinë ka bërë shënimin “*Joprezent*” për 13 punonjës, të cilët janë evidentuar më poshtë:

- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 11.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 28.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 14.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 11.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 11, 22, 23, 24 dhe 25.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 17.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, njësia administrative Kryevidh, joprezent në datën 11.04.2025;
- *****, me detyrë “*Përgjegjës i Shërbimeve Sociale*”, joprezent në datën 30.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 06.05.2025;

- *****, me detyrë “*Drejtor Arsimi*”, joprezent në datën 14.04.2025;
- *****, me detyrë “*Përgjegjës Turizmi*”, joprezent në datën 11, 14, 15, 16, 17, 18.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 02.05.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist*”, joprezent në datën 06.05.2025.

Nga grupi i monitorimit janë evidentuar mungesat e punonjësve dhe është raportuar pranë Komisionerit se janë verifikuar këto raste, duke arritur në konkluzionin se nuk ekzistojnë rrethanat për nisjen e ecurisë disiplinore, por për secilin prej tyre është dhënë masa administrative “*heqje e ditës së punës*”.

Në institucionin e Bashkisë Kavajë

Faqe| 26

Referuar prezencës në akt-konstatimet e dërguara nga grupi i monitorimit të ngritur pranë Bashkisë Kavajë, konstatohet se, për 7 punonjës janë evidentuar mungesa të pajustificuara, në data të caktuara, ndër të cilët:

- *****, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Gjellbërim Varrezave*”, joprezent në datën 11.04.2025 dhe 14.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist Agronom*”, njësia administrative Helmës, joprezent në datën 14.04.2025;
- *****, me detyrë “*Drejtor*”, Drejtoria e Urbanistikës, joprezent në datën 18.04.2025;
- *****, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Strehimit*”, joprezent në datën 18.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist Jurist*”, Sektori i Hartografisë, Kadastrës dhe GIS, joprezent në datën 18.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist Jurist*”, Sektori i Menaxhimit të Kontratave, joprezent në datën 18.04.2025;
- *****, me detyrë “*Specialist Inxhinieri*”, joprezent në datën 18.04.2025.

Sa i takon mosprezencës në punë për këto raste, Komisioneri ka kërkuar të verifikohet arsyeja për secilin punonjës nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe eprori direkt, nëse ata janë pjesë e shërbimit civil, për të vijuar më tej me marrjen e masave konkrete në përputhje me kërkesat e legjislacionit që normojnë marrdhënien e punës në shërbimin civil.

3. Situata e konstatuar në lidhje me administrimin e procesit të mbikëqyrjes së sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore, pas verifikimit në subjekt

Në funksion të realizimit të procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për nëpunësin civil gjatë periudhës zgjedhore, Komisioneri ka kryer verifikime të drejtpërdrejta në terren, me qëllim kontrollin e situatës faktike dhe garantimin e respektimit të parimeve të shërbimit civil. Ky kapitull paraqet veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të këtyre verifikimeve, përmes të cilave është synuar sigurimi i transparencës, objektivitetit, përputhshmërisë së të dhënave të

raportuara dhe mbështetjes institucionale për ruajtjen e integritetit të administratës publike gjatë fushatës zgjedhore.

Konkretisht, në zbatim të Urdhrit nr. 35 (nr. 46/1 prot.), datë 15.04.2025, të Komisionerit, “Për fillimin e procesit të monitorimit në subjekt të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me fokus emërimet e reja dhe sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhës së zgjedhjeve të përgjithshme për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë”, Komisioneri ka ushtruar inspektime ditore në 59 subjekte, ashtu si parashikohej në këtë urdhër të posaçëm.



Foto nga takimet e Grupit të Punës së Komisionerit me Grupet e Monitorimit respektivisht në Bashkitë Mallakastër dhe Fier

Monitorimi në subjekt u fokusua në verifikimin e të dhënave të raportuara nga Grupet e Monitorimit, si dhe për të evidentuar dhe adresuar probleme që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, kryesisht lidhur me disa çështje si:

- Emërimet e reja në punë, në pozicione të shërbimit civil.
- Pezullimet në shërbimin civil, për arsye të ndryshme.
- Dorëheqjet nga shërbimi civil.
- Largimet nga shërbimi civil, si nëpërmjet aplikimit të masës disiplinore, ashtu edhe për shkak të dy vlerësimeve negative.
- Masat disiplinore të llojeve të ndryshme, nëse ka pasur në këtë periudhë.
- Nëpunësit civilë të emëruar në organet zgjedhore, që janë: KZAZ, KQV, GNV dhe aktet e miratimit nga ana e institucionit për këtë veprimtari.
- Nëpunësit civilë që kandidojnë për deputetë, shoqëruar me aktet e pezullimit të tyre nga detyra, miratuar nga institucioni.
- Denoncimet në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me parregullsi në drejtim të zbatimit të ligjit, në lidhje me pjesëmarrjen në fushatë elektorale.
- Kallëzimet penale, nëse evidentohen për nëpunës civilë në institucionin përkatës, apo të masave të sigurisë që janë marrë për nëpunësit civilë nga prokuroria apo gjykata.
- Probleme të ndryshme që i kanë dalë gjatë procesit të monitorimit, Grupit të Monitorimit.

Në procesin e monitorimit në subjekt u angazhua Sekretariati i Komisionerit, i cili nëpërmjet procesverbaleve të mbajtuara me Grupet e Monitorimit të ngritura pranë institucioneve dhe relacioneve përkatëse, ka informuar Komisionerin në lidhje me ecurinë e procesit, si dhe zbatimin e ligjit për nëpunësin civil gjatë fushatës zgjedhore.

Gjatë monitorimit në subjekt Grupet e punës verifikuan mënyrën e plotësimit të “Akt-konstatimit” prej grupeve të monitorimit, si dhe i udhëzuan ata për administrimin e gjithë dokumentacionit provues në lidhje me mungesat dhe lëvizjet e justifikuara apo mungesat e pajustificuara të nëpunësve gjatë orarit zyrtar të punës.




Foto nga takimet e Grupit të Punës së Komisionerit me Grupet e Monitorimit respektivisht në Këshillin e Qarkut Kukës, Bashkitë Lezhë e Maliq, si dhe Këshilli i Qarkut Berat

Në lidhje me rastet e pretenduara si shkelje disiplinore, në drejtim të mosrespektimit të disiplinës në punë, siç janë mungesat e pajustificuara, Grupet e Monitorimit janë orientuar që t'i hetojnë rast pas rasti dhe më tej, të kërkojnë fillimin e ecurisë disiplinore pranë organeve disiplinore, duke vlerësuar rëndësinë e shkeljes së konstatuar.

Në rastet me mungesa deri në 3 ditë, janë orientuar që kërkesa të paraqitet tek eprori direkt, pasi shkelja konsiderohet si e lehtë, sipas parashikimeve të nenit 57, të ligjit për nëpunësin civil, ndërsa për rastet e evidentuara me mungesa të pajustificuara të punonjësit mbi 3 ditë,

janë orientuar që të paraqesin kërkesën pranë Komisionit të Disiplinës së institucionit, duke u konsideruar si shkelje të rënda e shumë të rënda disiplinore, sipas dispozitës së përmendur më sipër.

Ndërkohë, grupet e monitorimit janë orientuar që, në rast se gjatë hetimit rezulton se janë konsumuar elementët e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, nga ana e punonjësve që nuk janë paraqitur në punë pa leje, zgjidhja e çështjes t'i raportohet organeve të drejtësisë.

Ky është një proces që ende po vijon, pasi Komisioneri i ka kërkuar institucioneve hetimin e të gjitha rasteve të konstatuara me mungesa pa arsye.

Në rastet e tjera, kur problematikat nuk kanë qenë të natyrës së shkeljeve disiplinore, të tilla si kur është ometuar nënshkrimi, apo të rasteve kur nuk është materializuar justifikimi në regjistrin përkatës, ndërkohë që punonjësi ka qenë me leje ose në ushtrim të detyrës jashtë institucionit, ato janë zgjidhur me këshillim nga ana e Sekretariatit të Komisionerit.

KAPITULLI IV

ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT CIVIL NË LIDHJE ME DISA INSTITUTE TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL TË APLIKUARA GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Të dhënat e administruara në lidhje me veprimet e kryera për administrimin e burimeve njerëzore gjatë aplikimit të instituteve të veçanta të ligjit për nëpunësin civil, për periudhën e fushatës zgjedhore: 11.04.2025 - 11.05.2025, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 Administrimi i shërbimit civil gjatë periudhës zgjedhore, (të dhëna të grumbulluara gjatë monitorimit në subjekt)

Institucionet sipas tipologjisë	Emërime	Dorëheqje	Pensione	Masa disiplinore	Kallëzime
(1) Institucionet e pavarura		2		1	1
(2) Administrata shtetërore		6	2	1	
(3) Njësitë e Qeverisjes Vendore	1	6		5	
TOTALI	1	14	2	7	1

Faqe| 30

1. Aplikimi i instituteve të ligjit për nëpunësin civil: emërimi në pozicione të shërbimit civil; dorëheqja; pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil; lirimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit (*plotësimi i moshës për pension të plotë pleqërie*); transferimi në shërbimin civil

▲ Rastet e emërimeve në pozicione të shërbimit civil nga data 11.04.2025 deri në datën 11.05.2025

Rezulton se, për periudhën objekt monitorimi, vetëm në Bashkinë Mirditë ka pasur **(1)** një rast emërimi për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe bëhet fjalë për gjyqfituesin ***** , emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Arsim- Sporte*”, njësia Administrative Orosh, me urdhrin nr.166 (1691 prot.), datë 24.04.2025, në zbatim të vendimit nr. 2686 (80-2024-2719), datë 11.07.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Nëpërmjet udhëzuesit nr. 15 (52 prot.), datë 15.01.2025, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet e sistemit të shërbimit civil që për një periudhë kohore të përcaktuar (nga data 11.04.2025 deri në datën 11.05.2025) **të pezullohet procesi për të nisur procedura të reja rekrutimi** në të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil, me qëllim që të parandalohej mundësia për t’u përdorur si një mjet për të ndikuar negativisht në procesin zgjedhor. Ky udhëzim i Komisionerit **është zbatuar në mënyrë unanime nga të gjitha institucionet, pa asnjë kontestim.**

I njëjti ndalim është parashikuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 26.02.2025, “*Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të*

burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor përzgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”, i cili ka dalë pas udhëzimit të Komisionerit.

Referuar këtyre akteve rregullatore: udhëzimit të Komisionerit dhe VKM si më sipër, në rastet kur institucionet kanë vlerësuar se ndodhen në kushtet kur janë paraqitur nevojat të përligjura për të plotësuar pozicionet e punës dhe me qëllim që të mos pengohet veprimtaria e institucionit, i janë drejtuar Komisionerit duke kërkuar që të vlerësohet mundësia për shpalljen e **26** pozicioneve vakante (*bëhet fjalë për 2 institucione në tipologjinë e institucioneve të pavarura, Avokati i Popullit dhe Gjykata e Apelit, e Juridiksionit të Përgjithshëm*). Rezulton se është miratuar kërkesa për të gjitha pozicionet, pasi është konstatuar se ato kanë qenë të përligjura me nevojat e institucionit për të ushtruar veprimtarinë e tyre.

- ▲ Rastet kur është bërë efektiv instituti i dorëheqjes nga detyra gjatë fushatës zgjedhore, Faqe| 31
për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme, rezultojnë **14** raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes nga detyra, nga të cilat **2** raste, i përkasin institucioneve të pavarura; **6** raste, institucioneve të administratës shtetërore dhe **6** raste, njësive të qeverisjes vendore. Në të gjitha rastet janë respektuar kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

- ▲ Rastet e pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Instituti i pezullimit të nëpunësit civil, për shkak të pjesëmarrjes si kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, është aplikuar në **4** raste (**2** i përkasin institucioneve shtetërore, *Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe 2 njësive të vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Dibrë*) dhe rezulton se është respektuar kërkesa ligjore, për konstatimin e pezullimit të statusit të nëpunësit civil.

- ▲ Rastet e lirimit nga shërbimi civil për shkak të ligjit (*plotësimi të moshës për pension të plotë pleqërie*) për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Për të gjithë periudhën zgjedhore janë evidentuar **2** raste, të lirimit nga shërbimi civil, për shkak të plotësimi të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie, të cilat i përkasin **institucioneve të administratës shtetërore, (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore).**

- ▲ Rastet e transferimit nga shërbimi civil për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Gjatë kësaj periudhe, rezulton se instituti i transferimi nga shërbimi civil **nuk** ka gjetur aplikim në asnjë rast.

▲ Rastet e nisjes së ecuresë disiplinore për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Gjatë kësaj periudhe ka nisur ecuria disiplinore për **7** nëpunës civilë, nga të cilët **1** rast në institucionin e Kuvendit të Shqipërisë; **1** rast në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar; dhe **4** raste në institucionin e Bashkisë Kurbin.

Në të gjitha rastet, motivacioni për nisjen e ecuresë disiplinore në ngarkim të nëpunësve ka qenë për shkak të rekomandimeve të dhëna nga institucioni i KLSH-së, për punonjësit e Bashkisë Kurbin dhe për shkak të mospërbushjes së detyrës, në rastin e AKSIK.

▲ Rastet e kallëzimeve penale për periudhën 11.04.2025 - 11.05.2025

Komisioneri është njoftuar nga grupi i monitorimit të ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë se për një punonjës pranë këtij institucioni është regjistruar një kallzim penal njoftuar me shkresën nr. 10904 Prot., (R.C), të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Faqe| 32

Nisur nga analiza e të dhënave ditore të dërguara nga Grupet e Monitorimit, të ngritura në **200** institucione që punësojnë nëpunës civilë të administruara nga Sekretariati i Komisionerit, si dhe duke pasur parasysh situatën e konstatuar gjatë monitorimit nëpërmjet vizitave në subjekt të veprimtarisë dhe sjelljes së nëpunësve civilë gjatë kësaj fushate elektorale për zgjedhjet parlamentare, në përgjithësi, në këto institucione vërehet një sjellje korrekte e nëpunësve civilë, të cilët kanë respektuar parimet, kërkesat dhe procedurat e kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.

Gjatë këtij procesi, nuk janë konstatuar raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin, denoncimeve apo marrjes së masave disiplinore për nëpunësit që ushtrojnë funksionet pranë subjekteve të monitoruara të lidhura me procesin zgjedhor. Kjo situatë vlerësohet si një zhvillim pozitiv në drejtim të respektimit të parimit të paanësisë politike dhe qëndrueshmërisë në shërbimin civil.

KAPITULLI V

RESPEKTIMI I TË DREJTËS SË NËPUNËSIT CIVIL PËR T’U REGJISTRUAR SI KANDIDAT PËR DEPUTET NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, SI DHE KOMISIONER NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Respektimi i të drejtave të nëpunësit civil zë një vend thelbësor në ligjin aktual për nëpunësin civil, pasi passjell edhe zgjidhjen e shqetësimit real për garantimin e parimeve më të rëndësishme të shërbimit civil, të tilla si paanshmëria dhe integriteti.

Konkretisht, një prej aspekteve më të rëndësishme të ligjit për nëpunësit civil, që gjen zbatim në këtë situatë specifike, është respektimi i të drejtave politike të nëpunësit civil. Ky institut i ligjit është materializuar në nenin 37, titulluar “*Të drejtat politike*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili kornizon të drejtat politike të nëpunësit civil, ndër to edhe të drejtën e tij për të kandidur dhe për t’u zgjedhur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

Faqe| 33

Në lidhje me këtë aspekt, Komisioneri ka kërkuar dhe më tej, ka administruar të dhëna prej institucioneve, të cilat pasqyrojnë rastet kur nëpunësit civilë kanë shprehur interesin për t’u angazhuar në komisionet e administrimit zgjedhor në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, apo si Operator PIE.

Komisioneri e ka vlerësuar këtë pjesëmarrje si një veprimtari të jashtme të nëpunësit civil, pasi nuk përfshihet në detyrat e tij funksionale sipas përshkrimit të punës dhe nuk është një detyrim ligjor i parashikuar nga ndonjë ligj specifik. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 47, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet detyrimi i deklaramentit të interesave dhe pasurisë, është kërkuar që kjo veprimtari të autorizohet me një akt të veçantë nga titullari i institucionit, ashtu si e parashikon kjo dispozitë ligjore.

Në udhëzimet e dërguara institucioneve, gjatë këtyre zgjedhjeve, Komisioneri ka sjellë në vëmendjen e tyre, detyrimin për të unifikuar në bashkëpunim me KQZ-në, praktikën e hartimit dhe miratimit të autorizimeve që nxjerrin në këtë rast, duke parashikuar në përmbajtje të këtyre akteve, në mënyrë specifike edhe të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë që kanë lidhje me pjesëmarrjen në këto organe zgjedhore, përgjegjësitë administrative, civile dhe penale, sipas rastit, me qëllim që nëpunësi t’i njohë dhe t’i respektojë ato, duke ndikuar në këtë mënyrë që procesi zgjedhor të njohë rritje të integritetit dhe besueshmërisë së tij.

Nga ana tjetër, Komisioneri, për të mbështetur punonjësit, si dhe në ndihmë të veprimtarisë zgjedhore të KQZ-së, i ka kërkuar institucioneve që të mos bëhen pengesë për të dhënë këto leje.

Në vijim të monitorimit të procesit, Komisioneri ka konstatuar se nga ana e titullarit të institucionit, pas kërkesës së nëpunësit civil, është zbatuar kërkesa ligjore, për të lejuar nëpunësit civilë të marrin pjesë në këto kategori veprimtarish, të tilla si, pjesëmarrje në

administratën zgjedhore, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, duke nxjerrë edhe autorizimin përkatës.

Tabela nr. 5: Statistika në lidhje me pjesëmarrjen e nëpunësve civilë si kandidatë për zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 maj 2025 dhe si komisioner zgjedhor

Institucionet	Kandidat për deputet	Pjesëmarrja në komisionet zgjedhore (në përbërje të KZAZ-ve/KQV-ve/GNV-ve/PIE-ve)			
		KZAZ	KQV	GNV	PIE
(1) Institucionet e Pavarura	-	-	1	-	-
(2) Administrata Shtetërore	2	91	49	24	7
(3) Njësitë e Qeverisjes Vendore	2	110	207	55	3
TOTALI	4	201	257	79	10

Sa i takon punonjësve të angazhuar në komisionet zgjedhore, konstatohet se, institucionet ku këta punonjës ushtrojnë detyrën kanë miratuar autorizimet për lejimin e pjesëmarrjes së tyre në këto organe.

Megjithatë, vetëm në një institucion varësie ka patur raste kur nëpunësit kanë marrë pjesë në komisionet zgjedhore, pa njoftuar institucionin për miratimin e autorizimit. Konkretisht, me memon e dërguar nga Grupi i Monitorimit pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Meteorologjisë me Nr. 1152 Prot., datë 14.05.2025, ka rezultuar se, punonjësit: *****, *****, ***** dhe *****, me detyrë “*Specialist në Sektorin nr. 2, Fier*”, kanë marrë pjesë në organet zgjedhore, pa njoftuar njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit, për miratimin e autorizimeve përkatëse nga ky i fundit.

Komisioneri ka kërkuar sqarim të rastit, si dhe informacion në lidhje me qëndrimin që është mbajtur nga institucioni dhe është në pritje të tyre.

Për këtë rast, sjellim në vëmendje se, të dhënat e pasqyruara për pjesëmarrje në organet zgjedhore janë vetëm për një pjesë të punonjësve të punësuar në institucione shtetërore, pra vetëm për punonjësit ndaj të cilëve zbatohet ligji për nëpunësin civil. Nga ana tjetër, rezulton se në asnjë rast nuk ka pasur pengesa nga institucionet e shërbimit civil e konkretisht nga eprori direkt dhe njësia e personelit për të miratuar lejen me shkrim për këtë veprimtari dhe nga ana e nëpunësve civilë është vlerësuar drejt nevoja për angazhimin e tyre në procesin zgjedhor.

Nga sa është paraqitur në të dhënat e tabelës më sipër, vlerësohet se trupa e nëpunësve civilë vijon të ndihmojë në procesin e administrimit të zgjedhjeve, duke rritur nivelin teknik të administratës zgjedhore, e për pasojë duke konsoliduar standardet e zgjedhjeve, drejt atyre më të mirave të hapësirës evropiane.

Realizimi i procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil, gjatë fushatës zgjedhore, krahas qëllimit për të siguruar parimin e paanësisë politike të shërbimit civil, është konceptuar nga ana e Komisionerit edhe si një mbështetje e njësive të administrimit të burimeve njerëzore, për të realizuar detyrat e tyre funksionale, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për nëpunësin civil, të cilat shpesh paraqesin vështirësi dhe për shkak të natyrës së kontrollit që ato kanë, e për pasojë edhe të rezistencës së vazhdueshme që bëhet nga nëpunësit e të gjitha niveleve, për t'iu shmangur rregullave të qarta të disiplinës në punë, si dhe procedurave specifike që kërkohen të respektohen nga ligji i sipërcituar.

Vlerësojmë se, procesi i monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil ka ndihmuar si: **a)** në drejtim të forcimit të disiplinës në punë të administratës publike; **b)** në drejtim të zbatimit të parimit të paanësisë politike në administrimin e shërbimit civil; po ashtu edhe **c)** në drejtim të fuqizimit të rolit të njësive të administrimit të burimeve njerëzore në këto institucione, të cilat kanë probleme në drejtim të realizimit të detyrave të vështira funksionale që duhet të kryejnë sipas ligjit për nëpunësin civil, pasi shpesh ngarkohen me detyra të tjera, në ndihmë të veprimtarisë së njësive të strukturës së institucionit.

Komisioneri arrin në këtë përfundim, duke u nisur nga përmbajtja e akt-konstatimeve, në të cilat evidentohet një disiplinim i trupës së nëpunësve civilë, por edhe nga komunikimi me punonjësit e njësive të personelit, të cilët ndjehen të mbështetur, të vlerësuar dhe më të çliruar për të kryer detyrën e tyre funksionale, si nga eprorët e tyre, ashtu edhe nga nëpunësit civilë të institucionit. Nga ana e tyre raportohet se respektimi i disiplinës në punë është në nivele të larta, krahasuar kjo edhe me kohën e situatave normale, që nuk kanë të bëjnë me periudha zgjedhore.

KAPITULLI VI

VERIFIKIMI I INFORMACIONEVE TË DËRGUARA PRANË KOMISIONERIT

Komisioneri edhe në këtë proces zgjedhor, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar verifikimit të informacioneve të administruara lidhur me pretendime për parregullsi në sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor.

Me qëllim që qytetarët të jenë sa më pranë institucionit dhe të denoncojnë raste të cilat i vlerësojnë si sjellje në kundërshtim me ligjin të nëpunësve të administratës, në faqen zyrtare të Komisionerit në internet, krahas rubrikave ekzistuese që sigurojnë transparencën e institucionit në raport me qytetarët, u hap edhe një rubrikë tjetër e posaçme *“Denoncime në lidhje me sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore në raport me respektimin e detyrave të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil”*, për të lehtësuar ndërveprimin me ta.

Faqe| 36

Rezulton se në adresë të Komisionerit, gjatë kësaj periudhe, kanë ardhur disa denoncime, të cilat do t'i analizojmë në vijim.

*“Informacion për pjesëmarrjen e dy punonjëseve: ***** dhe ***** në fushatë elektorale, denoncuar nga subjekti “Partia Demokratike”*”

Nëpërmjet një denoncimi nga subjekti politik *“Partia Demokratike”*, i regjistruar me shkresën nr. 477 prot., datë 24.04.2025, Komisioneri është njohur me informacionin, në përmbajtje të të cilit pretendohet se, dy punonjëset ***** me detyrë *“Drejtore e Shërbimeve Sociale”* dhe ***** punonjëse në Drejtorinë e Tatimeve, të Bashkisë Vlorë, kanë marrë pjesë në aktivitete partiake në orarin zyrtar të punës dhe shfaqin në publik bindjet apo preferencat partiake në mënyrë të vazhdueshme.

Pas marrjes së këtij informacioni, Komisioneri, duke vlerësuar faktin se, kryerja e veprimeve, apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me parimet bazë të shërbimit civil, ndër të cilët edhe parimi i paanësisë politike, konsiderohet si shkelje e rëndë e disiplinës në shërbimin civil, nëpërmjet shkresës nr. 477/1 prot., datë 28.04.2025, *“Kërkesë, për marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të rastit të denoncuar nëpërmjet informacionit nr. 477, datë 24.04.2025, të ardhur nga subjekti politik “Partia Demokratike”, me objekt: “Kërkesë për nisjen e procedurës për lirimin nga shërbimi civil”*”, ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe Grupi i Monitorimit të institucionit, verifikimin e menjëhershëm të rastit.

Për këtë qëllim, Komisioneri ka kërkuar të evidentohet paraprakisht nëse shtetasit ***** dhe ***** janë punonjëse pranë Bashkisë Vlorë dhe nëse aktualisht kryejnë funksione në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, e më tej, nëse konstatohet ky fakt, të referohet rasti pranë organeve të disiplinës, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në kreun X *“Disiplina në shërbimin civil”*, nenet 57 deri 62, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*,

i ndryshuar, ku evidentohen llojet e shkeljeve të disiplinës në shërbimin civil, llojet e masave disiplinore dhe organet kompetente që fillojnë dhe finalizojnë një procedim disiplinor.

Për këtë arsye, grupi i punës i Komisionerit, u paraqit në datën 05.05.2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë për verifikimin e rastit në fjalë, duke sqaruar se kryerja e veprimeve apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me parimet bazë të shërbimit civil, ndër të cilat parimi i paanësisë politike, konsiderohet si shkelje e rëndë e disiplinës në shërbimin civil.

Gjatë verifikimit u konstatua se, me marrjen e shkresës së Komisionerit, njësia përgjegjëse e institucionit ka dërguar denoncimin menjëherë pranë eprorit të drejtpërdrejtë të nëpunësve, si organi kompetent për të klasifikuar shkeljen dhe për të nisur procedurën disiplinore për nëpunësit respektiv, fakt i provuar me aktet e administruara nga grupi i punës, të evidentuara më poshtë:

- 1- Shkresa nr. 6608/2, datë 02.05.2025, *“Informacion mbi elementë të klasifikuar si shkelje disiplinore”*, e njësisë përgjegjëse, drejtuar *****, me detyrë *“Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore”*, si epror direkt i nëpunëses *****, me detyrë *“Specialist Pranimi”*, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- 2- Shkresa nr. 6608/1, datë 20.05.2025, *“Informacion mbi elementë të klasifikuar si shkelje disiplinore”*, e njësisë përgjegjëse, drejtuar *****, me detyrë *“Drejtor i Përgjithshëm”*, si epror direkt i nëpunëses *****, me detyrë *“Drejtor në Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimit Social”*.

Gjithashtu, në momentin e verifikimit u administrua akt-konstatimi i datës 05.05.2025, për prezencën në punë të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, në të cilën kryejnë detyrën punonjëset në fjalë, si dhe u la detyrë që të njoftohet Komisioneri në lidhje me vendimarrjen e eprorit dhe zgjidhjen përfundimtare të rastit.

Komisioneri është në ndjekje të këtij rasti dhe ka kërkuar nga institucioni që në përfundim të trajtimit të tij, të njoftohet në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të denoncimeve të ardhura.

*“Denoncim nga subjekti politik “Partia Demokratike”, për punonjësen *****, me detyrë “Drejtoresh e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”*

Komisioneri nëpërmjet informacionit të regjistruar me shkresën nr. 480, datë 25.04.2025, ka administruar një denoncim të dërguar nga subjekti politik *“Partia Demokratike”*, në përmbajtje të të cilit pretendohet se, punonjësjë *****, me detyrë *“Drejtoresh e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit”*, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka marrë pjesë në aktivitete partiake në orarin zyrtar të punës dhe ka shfaqur në publik bindjet apo preferencat partiake në mënyrë të vazhdueshme.

Për verifikimin e këtij informacioni, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 480/1 prot., datë 28.04.2025, *“Kërkesë, për marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të rastit të denoncuar nëpërmjet informacionit nr. 480, datë 25.04.2025, të ardhur nga subjekti politik “Partia Demokratike”, me objekt: “Kërkesë për nisjen e procedurës për lirimin nga shërbimi civil”*”, ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore dhe Grupi i Monitorimit i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, verifikimin e menjëhershëm të rastit, bazuar në fotot e dërguara nga subjekti politik, apo edhe në prova dhe fakte të tjera që mund të administrohen në këtë rast, për të evidentuar paraprakisht nëse ***** është punonjëse e institucionit dhe nëse ajo aktualisht kryen funksione në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil. Njëkohësisht, ky informacion i është përcjellë edhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

Në lidhje me rastin në fjalë, DAP me shkresën nr. 2741/1 prot., të datës 30.04.2025, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 480/2 prot., datë 02.05.2025, ka kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të merren masat e nevojshme administrative, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, për shqyrtimin e pretendimeve për nëpunësen civile *****.

Faqe| 38

Koordinatori i institucionit ka informuar se rasti është duke u trajtuar, në përputhje me afatet administrative që kanë lidhje me institutin e disiplinës në shërbimin civil.

Komisioneri është në ndjekje të këtij rasti dhe ka kërkuar që të informohet menjëherë për përfundimin e trajtimit të tij nga institucioni.

“Denoncim për disa punonjës të Bashkisë Mirditë, për publikimin dhe shfaqjen publikisht në rrjete sociale të preferencave partiake”

Në postën elektronike në adresë të Komisionerit, në datën 05.05.2025, ka mbërritur një denoncim dërguar nga një subjekt anonim, në përmbajtje të të cilit pretendohet se, disa zyrtarë të administratës së Bashkisë Mirditë kanë shfaqur në publik bindjet apo preferencat partiake në mënyrë të vazhdueshme, duke dërguar si provë publikimin e spotit publicitar të një subjekti politik në rrjetin social *“Facebook”*.

Konkretisht, në përmbajtje të këtij informacioni kanë ardhur denoncime ndaj nëpunësesh ***** në pozicionin e punës, Jurist; ***** në pozicionin e punës IT, si dhe disa pozicione të tjera, të cilat janë të evidentuara në përmbajtjen e e-mailit në fjalë.

Në kushtet kur kryerja e veprimeve, apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me parimet bazë të sjelljes së nëpunësit civil konsiderohet thyerje e rëndë e disiplinës në punë, nëpërmjet shkresës nr. 497/1 prot., datë 08.05.2025, *“Kërkesë, për marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të rastit të denoncuar pranë Komisionerit, nëpërmjet postës elektronike, nga një subjekt anonim, në datën 05.05.2025, me objekt: “Përdorimi i nëpunësve të administratës publike në fushatën elektorale për subjektin “Partia Demokratike”*”, Komisioneri ka kërkuar

nga njësia përgjegjëse dhe Grupi i Monitorimit të institucionit, verifikimin e menjëhershëm të rastit, duke evidentuar fillimisht faktin nëse qytetarët e listuar janë punonjës të institucionit dhe nëse pozicionet e punës përfshihen në kategorinë e nëpunësve civilë, e më tej, të referohet rasti pranë organeve të disiplinës.

Në vijim, Komisioneri, me shkresën nr. 484 prot., datë 28.04.2025, ka risjellë dhe një herë në vëmendje për të gjitha institucionet të cilat punësojnë nëpunës civilë, se përdorimi i rrjeteve sociale, i platformave sociale apo mjeteve të tjera të komunikimit elektronik për qëllime të propagandimit apo shprehjes publike të bindjeve dhe preferencave politike përbën një veprim që vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për evidentimin e këtyre rasteve, Komisioneri ka kërkuar që grupet e monitorimit të tregojnë kujdes të posaçëm, sidomos në drejtim të saktësisimit të faktit, nëse subjekti i denoncuar është i njëjti person me përdoruesin e llogarisë në rrjet.

Faqe| 39

Në lidhje me sa më lart, nëpërmjet e-mailit të datës 20.05.2025, Bashkia Mirditë ka dërguar informacion në lidhje me masat e marra për verifikimin e këtyre rasteve. Konkretisht, në procesverbalin e mbajtur nga grupi i monitorimit, lidhur me punonjësit e përmendur në shkresë, rezulton se, vetëm punonjësja *****, me detyrë “Specialist IT”, është nëpunës civil, ndërsa përsa i përket punonjësve: *****, *****, ***** dhe *****, nuk janë nëpunës civilë dhe trajtohen me kod pune.

Gjithashtu, njësia përgjegjëse informon se, nëpërmjet e-mailit të datës 13.05.2025, është vënë në dijeni eprori direkt, i cili po e trajton rastin në përputhje me afatet procedurale që kanë lidhje me institutin e disiplinës në shërbimin civil.

Komisioneri është në ndjekje të rastit dhe ka kërkuar nga institucioni që në përfundim të trajtimit të tij, të njoftohet në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të denoncimit të ardhur.

“Denoncim për pjesëmarrjen në takime elektorale të subjekteve zgjedhore, brenda orarit zyrtar, nga disa punonjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër”

Nëpërmjet një e-maili, në datën 04.05.2025, në postën elektronike të institucionit, ka ardhur një denoncim nga adresa: *****@yahoo.com, në përmbajtje të të cilit pretendohet se, disa punonjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër kanë marrë pjesë në takime elektorale të subjekteve zgjedhore, brenda orarit zyrtar.

Në përmbajtjen e informacionit nuk është evidentuar asnjë nëpunës konkret dhe nuk është dërguar asnjë provë apo fakt, në lidhje me këtë pretendim. Nga ana e Komisionerit, është komunikuar menjëherë me Grupin e Monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore, për institucionin, nëpërmjet e-mailit zyrtar, si dhe më pas me shkresën nr. 501/1 prot., datë 09.05.2025, “Kërkojmë marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të

informacionit të regjistruar pranë Komisionerit, dërguar nëpërmjet postës elektronike të datës 04.05.2025, nga adresa *****@yahoo.com, ku pretendohet për pjesëmarrje të nëpunësve civilë në fushatën elektorale, në mbështetje të subjekteve zgjedhore të caktuara”, Komisioneri ka kërkuar nga Grupi i Monitorimit të institucionit, verifikimin e menjëhershëm të rastit, duke kërkuar që të verifikohen akt-konstatimet e mbajtura për prezencën në punë të punonjësve, e më tej, të referohet rasti pranë organeve të disiplinës.

Komisioneri vlerëson se kryerja e veprimeve, apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me parimet bazë të shërbimit civil, ndër të cilët edhe parimi i paanësisë politike, konsiderohet si shkelje e rëndë e disiplinës në shërbimin civil, e për këtë arsye ka, kërkuar nga institucioni që në përfundim të trajtimit të tij, të njoftohet në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të denoncimit të ardhur.

Institucioni ka njoftuar Komisionerin se për punonjësit e denoncuar është marrë masa administrative: *“heqje e ditës së punës”*.

Njëkohësisht, me shkresën nr. 1009/1 prot., datë 15.05.2025, regjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 501/2 prot., datë 19.05.2025, Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër ka informuar Komisionerin se, nga kontrollet e ushtruara nga Grupi i Monitorimit i ngritur në këtë institucion, nuk është konstatuar asnjë shkelje ligjore apo përfshirje në fushatën zgjedhore 2025 nga ana e punonjësve të DRT Dibër.

Në lidhje me këtë rast, edhe Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 2829/1 prot., datë 22.05.2025, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 501/3, datë 23.05.2025, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve marrjen e masave të nevojshme administrative për verifikimin e këtyre pretendimeve në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

*“Denoncim për punonjësen *****, për shprehjen e bindjeve politike në publik dhe zgjedhjen në organet e larta drejtuese të subjektit politik “Partia e Lirisë””*

Komisioneri, në datën 04.05.2025, nëpërmjet postës elektronike, ka marrë një denoncim të dërguar nga qytetarja ***** në përmbajtje të të cilit parashtrohet se, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore është konstatuar që nëpunësja ***** me detyrë *“Specialiste”*, në Degën e Thesarit Kolonjë, gjithashtu anëtare e Këshillit Bashkiak Korçë, është e zgjedhur në organet e larta drejtuese të subjektit politik, si dhe ka shprehur hapur bindjet e saj politike në mbështetje të këtij subjekti zgjedhor.

Komisioneri, pasi është njohur me përmbajtjen e denoncimit, nëpërmjet shkresës nr. 502/1 prot., datë 08.05.2025, *“Kërkojmë marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të rastit të denoncuar pranë Komisionerit, nëpërmjet postës elektronike të datës 04.05.2025, nga qytetarja Maria Pajo, ku pretendohet për pjesëmarrje të nëpunësve civilë në fushatën elektorale, në mbështetje të subjekteve zgjedhore të caktuara”*, ka kërkuar nga Grupi i Monitorimit të institucionit, verifikimin e menjëhershëm të rastit, duke evidentuar fillimisht

faktin nëse qytetarja është punonjëse e institucionit dhe nëse ajo aktualisht kryen funksione në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, e më tej, të referohet rasti pranë organeve të disiplinës.

Me këtë informacion është njohur edhe Departamenti i Administratës Publike, i cili ka reaguar nëpërmjet e-mailit zyrtar të datës 05.05.2025, duke i dërguar për kompetencë denoncimin përkatës, si dhe duke i kërkuar institucionit që të veprojë menjëherë për të verifikuar këtë rast. Për këtë fakt, Departamenti i Administratës Publike ka informuar edhe Komisionerin, nëpërmjet postës elektronike, në datën 05.05.2025.

Koordinatori i institucionit ka raportuar se rasti është duke u trajtuar; me urdhrin Nr. 75, datë 19.05.2025, të Ministrit të Financave, është ngritur Komisioni i Disiplinës.

Faqe| 41

Komisioneri është në ndjekje të këtij rasti dhe ka kërkuar nga institucioni që në përfundim të trajtimit të tij, të njoftohet në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të denoncimit të ardhur për nëpunësen *****.

*“Denoncim i ardhur nga “KRIIK Albania” për punonjësin *****, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore”, Korçë”*

Në datën 08.05.2025, nëpërmjet postës elektronike, të dërguar nga një subjekt anonim, ka ardhur nga “KRIIK Albania” denoncimi nr. 30, datë 08.05.2025, përmes të cilit është ngritur shqetësimi se, punonjësi ***** në takimin e datës 21 prill 2025, të zhvilluar nga Partia Socialiste në fshatin Dishnic të Qarkut Korçë, ka mbajtur një fjalim në mbështetje të këtij subjekti duke shprehur publikisht bindjet e tij politike.

Pasi u njoh me përmbajtjen e denoncimit, Komisioneri konstatoi se, ***** është punonjës pranë institucionit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, i cili nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këto kushte, trajtimi i këtij rasti nuk është në kompetencën lëndore të Komisionerit.

Nga ana tjetër, referuar Vendimit nr. 122, datë 26.2.02025, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”, punonjësit e administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, por pa shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike.

Ndodhur në këto rrethana, referuar nenit 24, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri vendosi të përcjellë aktet për kompetencë pranë Ministrisë së Financave, që është edhe organi publik që duhet të trajtojë këtë rast, si dhe ka njoftuar subjektin denoncues për këtë fakt. Në vijim, Departamenti i

Administratës Publike, me shkresën nr. 2844/1 prot., datë 22.05.2025, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 503/2 prot., datë 23.05.2025, ka njoftuar se informacionin për këtë nëpunës ia ka përcjellë për trajtim Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

*“Denoncim nga KQZ për përfshirjen e nëpunësit *****, me detyrë “Kapiten i Portit të Vlorës”, në veprimtari elektorale gjatë orarit zyrtar të punës”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 23.04.2025, është administruar një denoncim me nr. 133 ID, i përcjellë nga një sinjalizues anonim, në të cilin ngrihen pretendime për përfshirjen e nëpunësit *****, Kapiten i Portit të Vlorës, në veprimtari me karakter elektoral gjatë orarit zyrtar të punës.

Sipas pretendimeve të denoncuesit, në datën 11.04.2025, ora 11:30, ***** ka marrë pjesë në një takim me ministrin Çuçi dhe përfaqësues të operatorëve turistikë detarë, gjatë të cilit është ushtruar presion i hapur mbi pjesëmarrësit për mënyrën se si duhet të votojnë në zgjedhjet e datës 11 maj 2025. Në cilësinë e provës, denoncuesi ka përcjellë një link nga rrjetet sociale, i cili është administruar nga KQZ në kuadër të procesit verifikues.

Faqe| 42

Pas shqyrtimit të materialeve dhe në zbatim të nenit 91 dhe 169 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur fillimin e një hetimi administrativ për këtë çështje.

Në vijim, janë njoftuar palët e përfshira në këtë rast duke i lënë afat prej 48 orësh për paraqitjen e pretendimeve dhe kundërshtimeve mbi sa denoncohet, si dhe duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse, përfshirë dhe provat e paraqitura.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur pushimin e hetimit administrativ, pasi nuk u konstatuan mjaftueshëm prova për të vërtetuar shkeljen e pretenduar.

* * *

Për të gjitha informacionet e administruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të evidentuara sa më lart, Komisioneri ka kërkuar që: në rast se, pas verifikimit të informacionit, do të evidentohen shkelje që vërtetojnë sjellje apo veprime të nëpunësve civilë, që vijnë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pika 1 dhe 2, e tij - ku parashikohet shprehimisht se: “1) Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar dhe nuk duhet të shprehë hapur bindjet apo preferencat e tij politike; 2) Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre”, - çështja të referohet pranë organeve të disiplinës, që ligjërisht janë: eprori direkt dhe Komisioni i Disiplinës dhe të

vijohet me ndjekjen e procedurave të mëtejshme disiplinore që parashikohen në kreun X *”Disiplina në shërbimin civil”*, nenet 57 deri 62, të ligjit nr. 152/2013, *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku evidentohen llojet e shkeljeve të disiplinës në shërbimin civil, llojet e masave disiplinore dhe organet kompetente që fillojnë dhe finalizojnë një procedim disiplinor.

KAPITULLI VII

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET BRENDË VENDIT, PËRFAQËSUES TË ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARE DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE

Një komponent kyç i veprimtarisë së Komisionerit në përmbushje të mandatit të tij ligjor dhe në funksion të garantimit të një administrate publike profesionale, të qëndrueshme, të paanshme dhe të depolitizuar, në kuadër të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil dhe monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ka qenë bashkëpunimi i ngushtë me institucionet vendase, përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë, si dhe me organizata joqeveritare, që kontribuojnë në fushën e administrimit publik dhe mbrojtjen e parimeve të shtetit të së drejtës.

Faqe| 44

Konkretisht, në zbatim të parimit të llogaridhënies dhe në vijim të mbështetjes së vazhdueshme, por edhe të vlerësimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë për nismën e Komisionerit që synon të ndikojë pozitivisht në sjelljen e administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, në përputhje me standardet evropiane, si dhe në funksion të forcimit të shtetit ligjor, Komisioneri ka informuar Kuvendin, me shkresën nr. 429 prot., datë 03.04.2025, lidhur me masat e ndërmarra për të garantuar zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, në koherencë edhe me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve rregullatore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe Vendimit Nr. 122, datë 26.02.2025, të Këshillit të Ministrave.

Në kuadër të bashkëpunimit për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për nëpunësin civil gjatë zgjedhjeve të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, Komisioneri ka përcjellë në adresë të Departamentit të Administratës Publike shkresën Nr. 118 Prot., datë 05.02.2025, me anë të së cilës është dërguar për njohje dhe zbatim Udhëzuesi i Komisionerit Nr. 15, datë 15.01.2025, si dhe modelet e akteve që do të materializojnë procesin.

Në funksion të këtij procesi, Komisioneri ka kërkuar nga DAP që të marrë masat për të caktuar koordinatorin/koordinatorët, me të cilët do të komunikohet gjatë periudhës zgjedhore. Në përmbushje të kësaj kërkeje, DAP ka caktuar një koordinatör të përgjithshëm, si dhe koordinatörë të posaçëm për çdo institucion qendror të administratës shtetërore (*Kryeministria dhe ministritë e linjës*), të cilët kanë ndërvepruar ngushtësisht me inspektorët e Komisionerit të caktuar me Urdhrin e Brendshëm Nr. 9, datë 14.01.2025, për ndjekjen e ecurisë së procesit në këto subjekte, si në drejtim të verifikimit të të dhënave, ashtu edhe sa i takon problematikave të ndryshme të dala gjatë këtij procesi.

Ashtu siç do të pasqyrohet në vijim, në funksion të sigurimit të sjelljes korrekte dhe të paanshme të nëpunësve që kryejnë detyrat në sistemin e shërbimit civil, në këtë situatë specifike zgjedhore, ky bashkëpunim ka vijuar edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Prezencën e OSBE (ODIHR) në Tiranë.

Në realizimin e procesit të monitorimit, Komisioneri ka bashkëpunuar edhe me organizata joqeveritare. Në këtë rast përmendim Organizatën Jofitimprurëse Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) i cili ka monitoruar procesin zgjedhor përfshirë edhe angazhimin e nëpunësve civilë në fushatën e zhvilluar për zgjedhjet e datës 11 maj 2025.

▲ Bashkëpunimi me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Bashkëpunimi me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka nisur me shkresën nr.428 prot., datë 03.04.2025, drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përmes së cilës është paraqitur një informacion në lidhje me masat e marra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të zhvillimit normal të procesit zgjedhor, në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përgjatë fushatës zgjedhore.

Faqe| 45

Me qëllim mbështetjen e këtij institucioni, për zbatimin e drejtë dhe të unifikuar në praktikë të ligjit, në përmbajtjen e udhëzimeve të Komisionerit për procesin zgjedhor, janë orientuar institucionet për të evituar pengesat në pjesëmarrjen e kategorisë së nëpunësit civil në administratën zgjedhore të emëruar nga KQZ, në përbërje të komisioneve përkatëse.

Po kështu, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet, që, në bashkëpunim me KQZ-në, **të standardizojnë autorizimet** që lejojnë nëpunësit civilë, apo edhe të gjithë nëpunësit e tjerë të administratës publike, për të marrë pjesë në administratën zgjedhore, duke parashikuar shprehimisht në to, detyrimet, përgjegjësitë administrative, civile dhe penale, sipas rastit, si dhe të drejtat që ata kanë, me qëllim që nëpunësi t'i njohë dhe t'i respektojë ato, duke ndikuar në këtë mënyrë që procesi zgjedhor të njohë rritje të integritetit dhe besueshmërisë së tij.

Njëkohësisht, është kërkuar që institucionet, detyrimisht, të dërgojnë pranë KQZ-së dhe pranë Komisionerit këtë autorizim, menjëherë pasi ai të marrë fuqi ligjore, duke mos e lënë këtë proces të zhvillohet vetëm në vullnetin e punonjësit, të cilit i është miratuar kërkesa në këtë rast, për të dorëzuar këtë akt pranë institucioneve përkatëse.

Për të gjitha këto aspekte, është informuar edhe institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si në aspektin e një prej institucioneve të pavarura që punëson nëpunës civilë, ashtu edhe në cilësinë e institucionit që administron procesin zgjedhor.

Me qëllim që në raportim të përfshihen gjithë të dhënat që kanë lidhje me procesin e monitorimit, Komisioneri ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, edhe pas përfundimit të procesit zgjedhor, duke i kërkuar këtij institucioni, nëpërmjet shkresës nr. 533 prot., datë 23.05.2025, informacion në lidhje me konstatimet e tyre apo denoncime të regjistruara pranë këtij institucioni, për veprime të nëpunësve civilë të çdo niveli të administratës publike që vijnë në kundërshtim me rregullimet ligjore për administrimin e procesit zgjedhor, apo për administrimin e shërbimit civil, duke evidentuar punonjësin dhe

llojin e shkeljes, për rastet kur ata janë proceduar administrativisht, apo janë në proces hetimi administrativ.

Pas marrjes së informacionit, ecuria e këtij procesi do të ndiqet nga Komisioneri, për të vepruar më tej me verifikimin e rastit në bashkëpunim me institucionet përkatëse, në varësi të vendimit të marrë apo që do të merret nga KQZ.

Për të gjitha sa u parashtuan më sipër, Komisioneri vlerëson si nivelin e lartë të bashkëpunimit me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë procesit zgjedhor, ashtu edhe ndërhyrjen e këtij institucioni, nëpërmjet akteve rregullatore për të unifikuar qëndrimin në lidhje me respektimin dhe përcaktimin e kufijve të të drejtave politike që gëzojnë nëpunësit civilë gjatë procesit zgjedhor, duke lehtësuar procesin e hetimit administrativ të çdo rasti të pretenduar në shkelje të ligjit, sidomos në drejtim të identifikimit të llojit dhe rëndësisë së shkeljes disiplinore.

- ▲ Takim me përfaqësues të OSBE/ODHIR, në rolin e vëzhguesve afatgjatë, të atashuar në Qarkun e Gjirokastrës

Në zbatim të Urdhrit nr. 35 (nr. 46/1 prot.), datë 15.04.2025, të Komisionerit, “Për fillimin e procesit të monitorimit në subjekt të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me fokus emërimet e reja dhe sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhës së zgjedhjeve të përgjithshme për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë”, Grupi i punës, i ngarkuar nga Komisioneri, për monitorimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit zgjedhor për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, për vitin 2025, në Bashkitë e Qarkut Gjirokastrë, gjatë takimeve në subjekt, ka rënë në kontakt me një grup vëzhguesish të OSBE/ODIHR-it, me tagrin e përfaqësuesve të Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Shqipëri, i përbërë nga Zj.Tarja Raappana dhe Z.Vincent Godbillon, në rolin: “Vëzhgues afatgjatë”, për Qarkun e Gjirokastrës.

Gjatë bashkëbisedimit me grupin e mbikëqyrjes, këta vëzhgues kanë treguar interes për t’u njohur me kompetencat e institucionit të Komisionerit sipas legjislacionit të shërbimit civil, si dhe rolin e tij në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe kanë kërkuar një takim pune.



Foto nga takimi i Grupit të Punës së Komisionerit me përfaqësues të OSBE (ODIHR), në cilësinë e vëzhguesve afatgjatë, në Bashkinë Dropull

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, si dhe duke vlerësuar rolin e rëndësishëm të tyre, në përmbushjen e standardeve zgjedhore në vendin tonë, grupi i punës i KMSHC-së, i përbërë nga Drejtori i Mbikëqyrjes, si dhe 3 inspektorët e përfshirë në të, në datën 29 Prill 2025, organizuan një takim të përbashkët pune me vëzhguesit në fjalë. Takimi u zhvillua në ambientet e institucionit të Bashkisë Dropull, në të cilin morën pjesë Grupi i monitorimit i Bashkisë Dropull, i përbërë nga: *****, ***** dhe *****, si dhe grupi i punës i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për Qarkun e Gjirokastrës.

Në raport me interesimin e shfaqur nga grupi i vëzhguesve, për veprimtarinë e Komisionerit, ata u informuan për rolin që kryen institucioni në monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale; për udhëzimin përkatës që i është dërguar të gjitha institucioneve, pjesë e shërbimit civil, si dhe për metodologjinë përkatëse që do të ndiqet deri në përgatitjen e raportit përfundimtar të vlerësimit për situatën e konstatuar përgjatë periudhës zgjedhore. Lidhur me këtë proces, vëzhguesit u informuan gjithashtu, edhe mbi rolin që luajnë grupet e monitorimit të ngritura nga institucionet, si dhe me mënyrën e ndërveprimit të tyre me institucionin e KMSHC-së.

Në mënyrë të detajuar përfaqësuesit e Komisionerit, informuan lidhur me ngritjen dhe përbërjen e grupeve të monitorimit, formën dhe mënyrën e marrjes së informacionit për shkelje të ndryshme të disiplinës në shërbimin civil, të evidentuara nga grupe interesi apo grupet e monitorimit, trajtimin e tyre, si dhe për mënyrën e realizimit të monitorimit për të kontrolluar prezencën në punë të nëpunësve civilë. Gjithashtu, u sqarua koncepti i shkeljeve specifike të disiplinës në shërbimin civil, me një rëndësi të veçantë lidhur edhe me kontekstin zgjedhor, duke theksuar rastet e mungesave të pajustificuara, apo pjesëmarrjen në veprimtari politike, në kundërshtim me detyrimet dhe të drejtat politike të nëpunësve civilë.

Një tjetër aspekt që u diskutua me pjesëmarrësit në takim, është përmbajtja e raportimit ditor të subjekteve të përfshira në procesin e mbikëqyrjes, pranë Komisionerit, ku përfshihen, përveç situatës së prezencës ditore në punë, edhe rastet e emërimeve të reja në punë, në pozicione të shërbimit civil; rastet e pezullimeve në shërbimin civil, për arsye të ndryshme; rastet e dorëheqjes nga shërbimi civil; rastet e masave disiplinore të ndryshme, e të tjera.

Po ashtu u evidentua edhe bashkëpunimi i vendosur midis Komisionerit dhe organizmave kompetente për administrimin e procesit zgjedhor, ku përfshihet kryesisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke theksuar mbështetjen e Komisionerit për pjesëmarrjen e nëpunësve civilë në organet administrative që realizojnë procesin zgjedhor, të tilla si KZAZ, KQV dhe GNV, si dhe bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare si OSBE-ODIR, në vendin tonë e të tjerë, nëpërmjet informimit të tyre për veprimtarinë e Komisionerit për të mbështetur procesin zgjedhor, në drejtim të zbatimit të parimit të paanësisë politike në administrimin e shërbimit civil, e njëkohësisht të respektimit të të drejtave politike të nëpunësit civil, të përcaktuara në ligj.

Në përfundim të takimit, grupi i vëzhguesve, falënderoi në mënyrë të veçantë përfaqësuesit e Komisionerit për informimin lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni në kuadrin e

përgjithshëm të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë, e në veçanti për rolin e tij në unifikimin dhe standardizimin e sjelljes së nëpunësve civilë në drejtimin e shprehjes dhe manifestimit të bindjeve të tyre politike, përfshirë edhe ato që quhen “*rrjete sociale*”.

▲ Takim i përfaqësuesve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me drejtues të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Në datën 10 janar 2025, në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Komisionerit dhe Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), me kërkesën e këtij të fundit, gjatë të cilit u diskutuan çështje të rëndësishme lidhur me procesin zgjedhor të majit 2025, si dhe u analizua situata socio-politike aktuale dhe sfidat me të cilat përballët procesi zgjedhor, si: moscenimi i lirive dhe të drejtave politike të shtetasve; sigurimi i garancive për të ruajtur nga shpërdorimi burimet shtetërore; intimidimi dhe përdorimi i papërshtatshëm i punonjësve të administratës publike për qëllime elektorale, etj.

Faqe| 48

Nga të dy palët u vlerësua si i frytshëm bashkëpunimi i deritanishëm mes dy institucioneve, i cili ka qenë i tillë edhe në zgjedhjet e mëparshme, dhe njëkohësisht palët u angazhuan për ta vijuar më tej këtë bashkëpunim edhe përgjatë këtij procesi zgjedhor.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në datën 08.05.2025, pranë Komisionerit është depozituar Denoncimi Nr. 30 nga KRIIK, dërguar nëpërmjet postës elektronike nga një subjekt anonim, regjistruar pranë Komisionerit me Nr. 503 Prot., datë 09.05.2025, përmes të cilit është ngritur shqetësimi se, një punonjës, në takimin e datës 21 prill 2025, të zhvilluar nga Partia Socialiste në fshatin Dishnic të Qarkut Korçë, ka mbajtur një fjalim në mbështetje të këtij subjekti duke shprehur publikisht bindjet e tij politike.

Ndjekja e këtij rasti është adresuar nga Komisioneri, ashtu si është trajtuar në Kapitullin VI “*Verifikimi i informacioneve të dërguara pranë Komisionerit*”, të këtij raporti vlerësimi.

KAPITULLI VIII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga ana e Komisionerit është vlerësuar drejt rëndësia e parimit të integritetit të procesit zgjedhor, duke u kujdesur që të vendosen disa rregulla dhe standarde të qarta dhe të unifikuara nëpërmjet udhëzimeve të posaçme në drejtim të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë një procesi zgjedhor, e cila përbën një indikator të rëndësishëm të respektimit të këtij parimi.

Gjatë këtij procesi zgjedhor, Komisioneri ka mbikëqyrur zbatimin e këtyre standardeve, duke kërkuar nga institucionet përkatëse:

- **të ngrenë një sistem efektiv të ankesave**, çka nënkupton ekzistencën e një sistemi efektiv për regjistrimin dhe hetimin e ankesave të qytetarëve në lidhje me nëpunësin civil. Kjo kërkesë është respektuar, pasi të gjitha institucionet i kanë raportuar këto raste pranë Komisionerit;

Faqe | 49

- **të vendosin në efikasitet organet e disiplinës** që janë eprori direkt dhe Komisioni Disiplinor, si mekanizma kompetente për marrjen e masave disiplinore për nëpunësit që kryejnë shkelje të disiplinës.

Është kërkuar nga të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil, që të ngrenë Komisionin Disiplinor dhe të dërgojnë pranë Komisionerit një kopje të aktit administrativ që provon këtë fakt. Raportojmë me kënaqësi se ky proces është finalizuar me sukses dhe në të gjitha institucionet e mbikëqyrura në këtë rast, Komisioni i Disiplinës ka qenë funksional.

- **të organizohen trajnime të rregullta me nëpunësit civilë në lidhje me etikën në shërbimin civil dhe neutralitetin politik**, çka rezulton si objektiv i realizuar. Departamenti i Administratës Publike ka organizuar një sërë trajnimesh me nëpunës të institucioneve të tipologjive të ndryshme në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri vlerëson se:

- Nga analiza dhe trajtimi i të dhënave të dërguara nga Grupet e Monitorimit, të ngritura në **200** institucione të shërbimit civil, të cilat janë përpunuar më tej nga Sekretariati i Komisionerit gjatë procesit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, për vitin 2025, Komisioneri vlerëson se ka patur një sjellje korrekte të nëpunësve civilë, të cilët kanë respektuar parimet, kërkesat dhe procedurat e kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.
- Nëpunësit civilë mirëkuptuan procesin e monitorimit dhe nuk pati asnjë rezistencë ndaj vendosjes së disa rregullave të reja shtesë në lidhje me disiplinën në punë dhe i respektuan ato.

- Gjatë periudhës zgjedhore, trupa e nëpunësve civilë ka qenë në detyrë gjatë orarit zyrtar dhe për rastet e mungesave pa arsye, janë marrë masa, sipas rastit: duke mos i paguar ditën e punës ose janë dërguar për procedim disiplinor pranë organeve të disiplinës, për rastet kur janë konstatuar shkelje të disiplinës në shërbimin civil.

Komisioneri është duke e ndjekur ecurinë e verifikimit të rasteve të raportuara nga Grupet e Monitorimit si mungesa të pajustificuara, për të cilat ende nuk është marrë një vendim përfundimtar nga ana e subjekteve të ngarkuara nga ligji me këtë detyrë, me qëllim që të merren masat e nevojshme nëse rezulton se këto mungesa vlerësohen si pa arsye të përligjura.

- Në rastin e aplikimit të institutit të pezullimit, për shkak të pjesëmarrjes si kandidat për deputet, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi civil është i emëruar, vlerësojmë se është respektuar kërkesa ligjore, për konstatimin e pezullimit të statusit të nëpunësit civil, për shkak të ligjit.
- Në rastin e veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë, Komisioneri ka konstatuar se nga ana e titullarit të institucionit, pas kërkesës së nëpunësit civil, është zbatuar detyrimi ligjor, për të lejuar nëpunësit që të angazhohen në komisionet e administrimit zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, duke lëshuar edhe autorizimin përkatës.
- Rregullat e vendosura nga KQZ, për veprimtarinë e nëpunësve të administratës, ku përfshihen edhe nëpunësit civilë, kanë qenë në përputhje të plotë me ligjin për nëpunësin civil dhe kanë qartësuar subjektet për të dalluar llojin e shkeljes disiplinore.
- Komisioneri është duke ndjekur veprimet e KQZ-së, me qëllim që në përfundim të shqyrtimit të rasteve të ndërhyjë nëse evidentohen nëpunës civilë, të penalizuar për shkak të shkeljes së ligjit.
- Duke vlerësuar ecurinë e procesit të monitorimit dhe impaktin që ai pati në disiplinimin e administratës, Komisioneri vlerëson se ky proces duhet të vijojë edhe në rastet e proceseve zgjedhore në të ardhmen. Njësitë e burimeve njerëzore duhet të kujdesen që të sigurojnë një disiplinë korrekte edhe në situatën normale, pas zgjedhjeve.
- Për periudhën e monitorimit, nuk janë konstatuar raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, duke mos respektuar procedurën e konkurimit.
- Të mbështeten njësitë e burimeve njerëzore nga titullarët e institucioneve, si me personel, ashtu edhe duke vlerësuar rolin e tyre në administrimin e shërbimit civil.

- Komisioneri vlerëson se, duke vepruar në mbështetje të një procesi zgjedhor në përputhje me ligjin, ka ndihmuar për të siguruar një proces më të mirë zgjedhor në vendin tonë, drejt standardeve më të mira të Hapësirës Evropiane.
- Në përfundim, Komisioneri i falënderon institucionet e sistemit të shërbimit civil dhe nëpunësit që ishin aktorë të procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë këtij procesi zgjedhor, në përbërje të Grupit të Monitorimit, për bashkëpunimin dhe zbatimin me korrektesë të udhëzimeve të Komisionerit, si dhe gjithë institucionet e tjera që kanë mbështetur këtë proces, sipas fushës së tyre të veprimit.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



ANEKSI

NR. 1

Administrimi i procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore, në sistemin e shërbimit civil dhe ngritja e organeve që ndjekin procesin në subjekt

Nr.	Institucionet e Administratës Shtetërore (Kryeministria dhe institucionet e varësishë)	Urdhër i Brendshëm Për Ngritjen e Grupit të Monitorimit (Akt Nr./ datë)	Përbërja e Grupit të Monitorimit Emër Mbiemër , pozicioni i punës, (Kryetar/Anëtar)	Kordinatori i procesit Emër Mbiemër (pozicioni i punës)	Kontakt		Rregullore e Brendshme e Grupit të Monitorimit (Akt Nr./ datë)
					Telefon	e-mail	
1	Kryeministria	Urdhër Nr.17 (780/1 prot.), datë 13.2.2025	1. ***** - Drejtor i Departamentit të Miradministrimit Kryetar 2. ***** Drejtor në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave Anëtar 3. ***** Specialist në Departamentin e Miradministrimit Anëtar	***** Specialist në Departamentin e Miradministrimit	*****	*****@kryeministria.al	Akt Nr.780/2 prot., datë 14.2.2025
1	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE	Urdhër Nr.9 (65 prot.), datë 19.2.2025 Urdhër Nr.13 (65/2 prot.), datë 24.4.2025	1. ***** Drejtor, Drejtoria e Financës dhe Juridike ***** Kryetar *****, Specialist i Burimeve Njerëzore, Protokoll/Arkivit, Kryetar 2. *****, Përgjegjës, Sektori Juridik dhe Marrëdhënie me Jashtë, Anëtar 3. ***** Specilist Jurist Anëtar	***** Përgjegjës, Sektori Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë	*****	*****@aapaa.gov.al	Akt Nr.65/1 prot., datë 20.2.2025
2	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar	Urdhër Nr.42, datë 6.2.2025 Urdhër Nr.110, datë 10.04.2025	1. ***** Përgjegjës Sektori, Kryetar 2. ***** Specialist, Anëtar 3. ***** Nënpunës i Informacionit, Anëtar ***** Anëtar	***** Specialist	*****	*****@nsa.gov.al	Akt Nr.43 prot., datë 7.2.2025
3	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujrore	Urdhër Nr.44 (321 prot.), datë 19.2.2025	1. ***** Përgjegjës, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar 2. ***** Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar 3. ***** Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar	***** Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@ambu.gov.al	Akt Nr.321/1 prot., datë 19.2.2025
4	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	Urdhër Nr.24 (113/1 prot.), datë 14.2.2025	1. ***** Inspektor, Kryetar 2. ***** Përgjegjës, Sektori i Financës dhe Kontrollit të Brendshëm, Anëtar 3. ***** Specialist, Sektori i Publikimit, Informimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Anëtar	***** Specialist, Sektori i Publikimit, Informimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar	*****	*****@amshc.gov.al	Akt Nr.113/2 prot., datë 14.2.2025
5	Agjencia e Prokurimit Publik	Urdhër Nr.25 (1490/1 prot.), datë 17.2.2025	1. ***** Përgjegjës Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore, Kryetar 2. ***** Specialist i Burimeve Njerëzore, Anëtar 3. ***** Specialist, Sektori i Koordinimit, Anëtar	***** Specialist i Burimeve Njerëzore	*****	*****@app.gov.al	Akt Nr.1490 prot., datë 17.2.2025
6	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Urdhër Nr.19 (238 prot.), datë 17.2.2025	1. ***** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar 2. ***** Përgjegjës në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Anëtar 3. ***** Specialist, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar	***** Specialist, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@aspa.gov.al	Akt Nr.238/2 prot., datë 17.2.2025
7	Agjencia Telegrafike Shqiptare	Urdhër Nr.21 (112 prot.), datë 20.2.2025	1. ***** Drejtor i Drejtorisë së Lajmeve dhe Multimedias, Kryetar 2. ***** Përgjegjës i Sektorit të Lajmeve nga Bota, Anëtar 3. ***** Drejtor i Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar 4. ***** Përgjegjës i Sektorit të Lajmeve nga Kronika, Kulturë, Sport, Sociale, Anëtar 5. ***** Specialist Jurist, Anëtar	***** Specialist Jurist	*****	*****@ata.gov.al	Akt Nr.112/2 prot., datë 20.2.2025
8	Avokatura e Shtetit	Urdhër Nr.69 (247/1 prot.), datë 3.2.2025	1. ***** Specialist Finance/Nënpunës Zbatues, Kryetar 2. ***** Specialist për Burimet Njerëzore, Koordinator 3. ***** Specialist për Prokurimet, Anëtar	***** Specialist për Burimet Njerëzore	0695298632	Anjeza.Koleka@avokaturashetit.gov.al	Akt Nr.247/3 prot., datë 4.2.2025
9	Departamenti i Administratës Publike	Urdhër Nr.150 (1033/1 prot.) datë 10.2.2025	1. ***** Kryetar 2. ***** Anëtar 3. ***** Anëtar	***** Specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit të Shërbimit Civil	*****	*****@dap.gov.al	Akt Nr.1033/3 prot., datë 11.2.2025
10	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Urdhër Nr.149 (1762 prot.), datë 17.2.2025	1. ***** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Kryetar 2. ***** Përgjegjës i Njësisë së Burimet Njerëzore Koordinator 3. ***** Specialist Anëtar 4. ***** Specialist Anëtar 5. ***** Përgjegjës Sektori Anëtar	***** Përgjegjës i Njësisë së Burimet Njerëzore Koordinator	*****	*****@arkiva.gov.al	Akt Nr.1762/2 prot., datë 17.2.2025
11	Inspektoriati Qendror	Urdhër Nr.8 (129 prot.), datë 21.2.2025	1. ***** Specialist, DMIUMK, Kryetar 2. ***** Specialist, Sektori Juridik, Anëtar 3. ***** Specialist, DMIUMK, Anëtar	***** Specialist, Sektori Juridik	*****	*****@insq.gov.al	Akt Nr.129/1 prot., datë 21.2.2025
12	Komiteti për Pakicat Kombëtare	Urdhër Nr.12 (35 prot.), datë 12.2.2025	1.***** Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Kryetar 2. ***** Përgjegjës i Sektorit të Projekteve Anëtar 3. ***** Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Anëtar	***** Përgjegjës i Sektorit të Projekteve	*****	*****@pakicatkombetare.gov.al	Akt Nr.35/1 prot., datë 12.2.2025
13	Komiteti Shtetëror për Kultet	Urdhër Nr.17 (80 prot.), datë 28.2.2025	1. ***** - Kryetar 2. ***** - Anëtar 3. ***** - Anëtar	*****	*****	*****@kshk.gov.al	Akt Nr.80/1 prot., datë 28.2.2025
14	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	Urdhër Nr.62 (262/2 prot.), datë 19.2.2025	1. ***** Specialist Jurist, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Kryetar 2. ***** Specialist i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Anëtar 3. ***** Koordinator në Zyrën e Koordinimit Anëtar	***** Specialist i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@saspac.gov.al	Akt Nr.262/2 prot., datë 20.2.2025
15	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit	Urdhër Nr.6 (210 prot.), datë 17.2.2025	1. ***** Drejtor i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ - Kryetar 2. ***** Specialist i Burimeve Njerëzore - Anëtar 3. ***** Specialist i Sektorit të Hetimit Administrativ - Anëtar	***** Specialist i Burimeve Njerëzore	*****	grisilda.telhaj@dpak.gov.al	Akt Nr.210/1 prot., datë 17.2.2025
2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Urdhër Nr.1167/1 datë 15.2.2025	1.***** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore 2.***** Specialist i Burimeve Njerëzore 3.***** Specialist i Burimeve Njerëzore	***** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore	*****	Eridiola.Marini@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.1167/2 prot., datë 20.2.2025
1	Agjencia Kombëtare Bërthamore	Urdhër Nr.8, datë 10.2.2025	1.***** Specialist në Sektorin e Analizës 2.***** Specialist në Sektorin e Analizës 3.***** Specialist në Sektorin e Analizës.	***** Specialist në Sektorin e Analizës	*****	Eridiola.Marini@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.21/2 prot., datë 10.2.2025
2	Agjencia e Eficencës së Energjisë	Urdhër Nr.17 datë 17.2.2025	1.***** Përgjegjës Sektori 2.***** Specialist i Burimeve Njerëzore 3.***** Specialist	***** Specialist i Burimeve Njerëzore	*****	*****@eficenca.gov.al	Akt Nr.103/1 prot., datë 17.2.2025

3	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë në Miniera	Urdhër Nr.318/3 datë 18.2.2025	1.*****, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit 2.*****, Drejtor i Drejtorisë së Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera 3.*****, Përgjegjës Sektori të Burimeve Njerëzore, Marrëdhënie Juridike dhe Komunikimit	***** Përgjegjës Sektori të Burimeve Njerëzore, Marrëdhënie Juridike dhe Komunikimit.	*****	*****@aksem.gov.al	Akt Nr.318/1 prot., datë 18.2.2025
4	Agjencia Shtetërore për Shpronësim	Urdhër Nr.32 datë 20.2.2025	1.*****, Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës. 2.*****, Specialist, Bueimeve Njerëzore. 3.*****, Specialist i Asistencës Ligjore.	***** Përgjegjës, i Buxhetit dhe Financës	*****	*****@ashsh.gov.al	Akt Nr.358/1 prot., datë 21.2.2025
5	Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse EITI	Urdhër Nr.44 datë 19.2.2025	1.*****, Përgjegjës i Sektorit Mbështetës. 2.***** Specialist. 3.*****, Specialist.	***** Përgjegjës i Sektorit Mbështetës.	*****	*****@albeiti.gov.al	Akt Nr.44/1 prot., datë 19.2.2025
6	Instituti i Transportit	Urdhër Nr.6 datë 17.2.2025	1.*****, Përgjegjës e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse. 2.*****, Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve dhe Studimeve. 3.***** Specialiste e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.	***** Specialiste e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.	*****	*****@ital.gov.al	Akt Nr.43/2 prot., datë 18.2.2025
7	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtitimit të Kimikateve (QGTKRR)	Urdhër Nr.2 datë 25.2.2025	1.***** Teknik i mesëm 2.***** Teknik i mesëm 3.***** Teknik i mesëm	***** Teknik i mesëm	*****	*****@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.221/1 datë 25.2.2025
8	Drejtoria e Përgjithshme Detare	Urdhër Nr.24 datë 20.2.2025	1.*****, Drejtoreshë në Drejtorinë e Financës. 2.*****, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore. 3.***** Specialiste protokolli.	***** Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.	*****	*****@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.314/1 prot., datë 20.2.2025
9	Arkivi Qëndror Teknik	UrdhërNr.90/1 datë 18.2.2025	1.***** Përgjegjëse Finance 2.***** Përgjegjës Fondi Arkivor 3.***** Specialiste	***** Përgjegjëse Finance	*****	*****@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.90/1 prot., datë 18.2.2025
10	Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar	Urdhër Nr.13, datë 18.2.2025	1.*****, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse) 2.*****, Specialiste në Sek. Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore 3.*****, përgjegjës i Sek. Financ, Burimeve Njerëzore.	***** Specialist në Sektorin e Financës Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Financës	*****	*****@gsa.gov.al *****@yahoo.com	Nr.272/1 prot., datë 20.2.2025
11	Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore	Urdhër Nr.3 datë 20.2.2025	1. *****, Drejtor Ekzekutiv 2. *****, Përgjegjës i Departamentit të Ndërveprimit 3. *****, Përgjegjës i Departamentit të Sigurisë	***** Përgjegjës i Departamentit të Ndërveprimit	*****	*****@infrastruktura.gov.al	Nr.39/1 prot., datë 21,2,2025
12	Autoriteti Rregullator Hekurudhor	Urdhër Nr.1167/1 datë 15.2.2025	1. ***** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore 2. ***** Specialist i Burimeve Njerëzore 3.***** Specialist i Burimeve Njerëzore	***** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore	*****	*****@infrastruktura.gov.al	Akt Nr.1167/2 prot., datë 20.2.2025
3	Ministria e Mbrojtjes	Urdhër Nr.868 prot., datë 20.2.2025	1. Kolonel *****, Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve-Kryetar 2. Nënkolonel *****, Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Personelit Ushtarak dhe Civil, Anëtar 3. Major-*****, Specialist në Sektorin e Zhvillimit, Arsimit dhe Kualifikimit, Anëtar	***** Specialist- në Sektorin e Menaxhimit të Personelit Ushtarak dhe Civil	*****	*****@mod.gov.al	Akt Nr.318 (868 prot.,) datë 20.2.2025
1	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Urdhër Nr.76 (Nr.564/1 prot.,) datë 6.3.2025 Urdhër Nr.120 datë 22.4.2025	1. *****, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore-Kryetar 2. *****, Përgjegjës i Sektorit të Shtypit-Anëtar 3.***** Specialist e Sektorit të Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhnieve me Pulikun - Anëtar 4. *****, Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore-Anëtar	***** Specialiste e Sektorit të Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhnieve me Pulikun	*****	*****@mod.gov.al	Akt Nr.564/2 prot., datë 6.3.2025
2	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit	Urdhër Nr.58, (Nr.408 prot.,) datë 6.3.2025	1. *****, Drejtor i DMBNJ-Kryetar 2. *****, Specialist i Burimeve Njerëzore-Anëtare 3.*****, Specialist Finance-Anëtare	***** Specialist i Burimeve Njerëzore-Anëtare	*****	*****@mod.gov.al	Akt Nr.59 (408/1, prot), datë 7.3.2025
4	Ministria e Brendshme	Urdhër Nr.1369/1 prot. datë 11.2.2025	1. *****, Drejtor, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Kryetar; 2. *****, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Aparatit, Anëtar; 3. *****, Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit, Anëtar; 4. *****, Përgjegjës i Sektorit të Migracionit, Anëtar; 5. *****, Specialist, Sektori i Këshillimit dhe Monitorimit të ImpAktit të Akteve Rregullatore, Anëtar; 6. *****, Specialist, Sektori i Hartimit dhe Unifikimit të Procedurave, Anëtar; 7. *****, Specialist, Sektori i Monitorimit, Anëtar.	***** Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Aparatit	*****	*****@mb.gov.al	Akt Nr.1369/2 prot., datë 14.2.2025
1	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Urdhër Nr.175/4, datë 24.2.2025	1.*****, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Kryetar; 2.*****, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Ekonomike për Aparatin, Anëtar; 3. *****, Inspektor në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Anëtar.	***** Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Ekonomike për Aparatin	*****	*****@asp.gov.al	Akt i datës 24.2.2025
2	Agjencia e Mbrojtjes Policore	Urdhër Nr.96 (790 prot), datë 11.2.2025	1. *****, Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar; 2. *****, Shëf i Sektorit të Shërbimeve Logjistike dhe Burimeve Njerëzore, Anëtar; 3. *****, Specialist i Burimeve Njerëzore/ Jurist, Anëtar	***** Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@amp.gov.al	Akt Nr.806 prot., datë 12.2.2024
3	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	Urdhër Nr.237, datë13.3.2025	1. *****, Përgjegjës sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar; 2. *****, Juriste, Anëtar; 3. *****, Specialist për Marrjen në Administrim të Pasurive, Anëtar	***** Përgjegjës sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@aapsk.gov.al	Akt Nr.1268/1 prot datë 18.3.2025
4	Prefekti i Qarkut Berat	Urdhër Nr.29, datë 6.3.2025	1. *****, Përgjegjës Sektori Juridik, Kryetar; 2. *****, Specialist Burimeve Njerëzore, Anëtar; 3. *****, Specialist Zhvillimi Urban, Anëtar	***** Specialist Burimeve Njerëzore	*****	*****@yahoo.com	Akt Nr.209/2 prot, datë 6.3.2025
5	Prefekti i Qarkut Dibër	Urdhër Nr.15, datë 7.3.2025	1. *****, Sekretare e Përgjithshme, Kryetar; 2. *****, Përgjegjës i Sektorit Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar; 3. *****, Specialist Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar	***** Specialist Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	Fatbardha.Cenga@mb.gov.al mevianselmani@yahoo.com	Akt Nr.16, datë 10.3.2025
6	Prefekti i Qarkut Durrës	Urdhër Nr.19, datë 13.3.2025	1. *****, Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar; 2. *****, Specialiste Burimeve Njerëzore, Anëtar; 3. *****, Përgjegjës Sektori Juridik, Anëtar	***** Specialiste Burimeve Njerëzore	*****	*****@hotmail.com	Akt Nr.190/1 prot datë 13.3.2025
7	Prefekti i Qarkut Elbasan	Urdhër Nr.49, datë 5.3.2025	1. *****, Sekretare e Përgjithshme, Kryetare; 2. *****, Specialiste e Burimeve Njerëzore në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar; 3. *****, Specialist e Sektorit Juridik, Anëtar	***** Specialiste e Burimeve Njerëzore	*****	*****@yahoo.com	Akt Nr.376/2 prot, datë 5.3.2025

8	Prefekti i Qarkut Fier	Urdhër Nr.22, datë 6.3.2025	1. ***** , Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar; 2.***** , Specialiste Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar; 3.***** , Specialist Sektori Juridik, Anëtar.	***** Specialiste Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar;	*****	*****@prefektifier.gov.al	Akt Nr.304 prot, datë 6.3.2025
9	Prefekti i Qarkut Gjirokastrë	Urdhër Nr.51, datë 10.3.2025	1.***** , Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar; 2. ***** , Specialist Sektorit Zhvillimit Urban, Anëtar; 3. ***** , Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar	***** Përgjegjës i Sektorit Juridik	*****	*****@prefektiquarkutgjirokaster.gov.al	Akt Nr.243, datë 10.3.2025
10	Prefekti i Qarkut Korçë	Urdhër Nr.3 (15 prot.), datë 7.1.2025	1. ***** , specialiste, Juriste ne Sektorin Juridik, Kryetar 2. ***** , specialiste; ne Sektorin e Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese, Anetar; 3. ***** , specialist ne Sektorin e Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese, Anetar	***** Sekretar i Përgjithëm	*****	*****@mb.gov.al	Akt Nr.15/1 prot., datë 14.2.2025
11	Prefekti i Qarkut Kukës	Urdhër Nr.54, datë 10.3.2025	1. ***** , Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar; 2. ***** , Specialist Sektorit Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Anëtar; 3. ***** , Specialiste e Sektorit Juridik, Anëtar	***** Specialist Sektorit Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@prefekturakukes.gov.al	Akt Nr.233 prot, datë 10.3.2025
12	Prefekti i Qarkut Lezhë	Urdhër Nr.37, datë 6.3.2025	1 ***** , Sek i Përgj Kryetar; 2. ***** , Përgjegjës Sektori, Anëtar; 3. ***** , Përgjegjës Sektori, Anëtar; 4. ***** , Përgjegjës Sektori, Anëtar; 5. ***** , Përgjegjës Sektori, Anëtar; 6. ***** , Përgjegjës Sektori, Anëtar.	***** Specialist Finances dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@prefektilezhe.gov.al	Akt Nr.240/2 prot, datë 6.3.2025
13	Prefekti i Qarkut Shkodër	Urdhër Nr.21, datë 5.3.2025	1. ***** , Sekretar i Përgjithshëm, Kryetar; 2. ***** , Përgjegjës Sektori Juridik, Anëtar; 3. ***** , Specialiste e Burimeve Njerëzore, Anëtar	***** Specialiste e Burimeve Njerëzore,	*****	albanabushati@yahoo.com	Akt Nr.177/1 prot, datë 5.3.2025
14	Prefekti i Qarkut Tiranë	Urdhër Nr.29, datë 6.3.2025	1. ***** , Përgjegjës Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar; 2. ***** , Specialiste e Burimeve Njerëzore, Anëtar; 3. ***** , Specialiste e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguar,Anëtar	***** Përgjegjës Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@prefektitirane.gov.al	Akt Nr.349/1 prot, datë 6.3.2025
15	Prefekti i Qarkut Vlorë	Urdhër Nr.24, datë 12.3.2025	1. ***** , Specialiste e Burimeve Njerëzore, Kryetar; 2. ***** , Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, Anëtar 3. ***** , Specialist IT, Anëtar	***** Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara	*****	*****@prefektiquarkutvlore.gov.al	Akt Nr.315/1, datë 12.3.2025
5	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Urdhër Nr.183, datë 14.2.2025	1.***** , Drejtor Burimeve Njerëzore/Kryetar 2.***** , Përgjegjese Sektori, BMNJ/Anëtare 3.***** , Specialist, Drejtoria Burimeve Njerëzore/Anëtar	***** Specialist, Drejtoria Burimeve Njerëzore	*****	*****@mfa.gov.al	Akt Nr.2185/2 prot., datë 14.2.2025
1	Agjensia Kombëtare e Diasporës	Urdhër Nr.11, datë 17.2.2025	1. ***** , Specialiste në Drejtorinë e Finacës dhe Shërbimeve Mbështetse/ Kryetare	***** Specialist Sektorit Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	*****	*****@mfa.gov.al	Akt Nr.42/2 prot., datë 18.2.2025
6	Ministria e Financave	Urdhër Nr.2783/1.datë 10.2.2025	1.***** Drejtor , Kryetar, 2.***** pergegjes sektori , Anëtare, 3.***** pergegjes sek , Anëtar, 4.***** specialist BNjer, Anëtar, 5.***** specialiste , Anëtare, 6.***** , specialiste , Anëtare, 7.***** , specialiste , Anëtare, 8.***** , specialiste , Anëtare, 9.***** , specialist , Anëtare, 10.***** , specialist , Anëtar, 11.***** , specialiste , Anëtare, 12.***** , specialiste , Anëtare, 13.***** , specialiste , Anëtare, 14.***** , specialiste , Anëtare,	*****	*****	*****@financa.gov.al	Akt Nr.2783/2., datë,14.2.2025
1	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës dhe Pasurisë	Urdhër Nr.2783/1.datë 10.2.2025	1.***** Drejtor , Kryetar, 2.***** pergegjes sektori , Anëtare, 3.***** pergegjes sek , Anëtar, 4.***** specialist BNjer, Anëtar, 5.***** specialiste , Anëtare, 6.***** , specialiste , Anëtare, 7.***** , specialiste , Anëtare, 8.***** , specialiste , Anëtare, 9.***** , specialist , Anëtare, 10.***** , specialist , Anëtar, 11.***** , specialiste , Anëtare, 12.***** , specialiste , Anëtare, 13.***** , specialiste , Anëtare, 14.***** , specialiste , Anëtare,	*****	*****	*****@financa.gov.al	Akt Nr.2783/2., datë,14.2.2025
2	Degët e Thesarit	Urdhër Nr.2783/1.datë 10.2.2025	1.***** Drejtor , Kryetar, 2.***** , pergegjes sektori , Anëtare, 3.***** , pergegjes sek , Anëtar, 4.***** , specialist BNjer, Anëtar, 5.***** , specialiste , Anëtare, 6.***** , specialiste , Anëtare, 7.***** , specialiste , Anëtare, 8.***** ,specialiste , Anëtare, 9.***** ,specialist , Anëtare, 10.***** specialist , Anëtar, 11.***** , specialiste , Anëtare, 12.***** , specialiste , Anëtare, 13.***** , specialiste , Anëtare, 14.***** ,specialiste ,Anëtare,	*****	*****	*****j@financa.gov.al	Akt Nr.2783/2., datë,14.2.2025
3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Urdhër Nr.8, datë 5.3.2025	1. ***** , Kryetar, Zv Drejtor I Përgjithshëm, 2.***** , Anëtare, Përgjegjese e burimeve njerëzore, 3.***** , Anëtare, Drejtoria antikorrupsion	*****	*****	maonika.dushku@dogana.gov.al	Akt Nr.4132/1., datë,05.3.2025
4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Urdhër Nr.77, datë 25.2.2025	1.***** , Kryetar, Drejtoria e burimeve njerëzore, 2.***** , Anëtare, Drejtoria e shërbimeve mbështetëse, 3.***** , Anëtare, Drejtoria antikorrupsion	*****	*****	*****@tatime.gov.al	Akt Nr.3234/1., datë,24.2.2025
5	Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore	Urdhër Nr11,datë 14.2.2025	1. ***** , Kryetar, Drejtor I programeve, 2. ***** , Anëtare, Drejtor I trajnimeve, 3. ***** , Anëtare, shef protokolli.	*****	*****	*****@financa.gov.al	Akt Nr.63/1., datë,22.2.2025
6	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe KontrAktmeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorët e tjerë	Urdhër Nr.5,datë 11.2.2025	1.***** , Kryetar, Drejtor I pergjithshem, 2.***** , Anëtare, Specialiste e kontrolli te brendshem, 3.***** , Anëtare, Përgjegjes I prokurimeve, 4.***** , Anëtare, Specialiste e kontabilitetit,	*****	*****	*****j@financa.gov.al	Akt Nr.118/1., datë,11.2.2025

7	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit	Urdhër Nr.28,datë 18.2.2025	1.*****, Kryetar, Përgjegjës i burimeve njerezore, 2.*****, Anëtare, Përgjegjës e Finances, 3.*****, Anëtare, Keshilltare e Kryetarit,	*****	*****	erjon.lalaj@amfl.gov.al	Akt Nr.311/1., datë,18.2.2025
7	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Urdhër Nr.64, datë 12.2.2025	1.*****, Përgjegjes Sektori i Koordinimit me Institucionet ne Varesi, Kryetar, 2.*****, Specialist ne Sektorin e Burimeve Njerezore, anetar, 3.*****, Specialist Sektori i Koordinimit me Institucionet ne Varesi, anetar	***** Përgjegjes Sektori i Koordinimit me Institucionet ne Varesi	*****	*****@arsimi.gov.al	Akt Nr.966/5 datë 17.2.2025
1	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë	Urdhër Nr.7, datë 18.2.2025	1.*****, Specialist Jurist Sektori i Sherbimeve mbeshtetese, kryetar, 2.*****, Specialist Sektori i analizes dhe Monitorimit, anetar, 3.*****, Specialist Sektori i Satistikave, anetar,	***** Specialist Jurist Sektori i Sherbimeve mbeshtetese	*****	*****@arsimi.gov.al	Akt Nr.47/2 prot datë 20.2.2025
2	Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	Urdhër Nr.18, datë 17.2.2025	1.*****, Drejtor i Drejtorise se Programeve Nderkombetare, kryetar, 2.*****, Përgjegjes i Sektorit të Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese, anetar, 3.*****, Specialist per Burimet Njerezore /Aktvst/Protokollist, anetar.	***** Specialist per Burimet Njerezore /Aktvst/Protokollist	*****	*****@nasri.gov.al	Akt Nr.425/2 prot datë 17.2.2025
3	Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar	Urdhër Nr.41, datë 17.2.2025	1.*****, Specialist ne Sektorin e Kualifikimit dhe Zhvillimit Profesional, kryetar, 2.*****, Specialist ne Sektorin e Finances, anetar, 3.*****, Specialist ne Sektorin e Kualifikimit dhe Zhvillimit Profesional, anetar,	***** Specialist ne Sektorin e Finances	*****	*****@ascap.edu.al	Akt Nr.292/1 datë 18.2.2025
8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Urdhër Nr.147, datë 19.2.2025	1.*****, Drejor i BNJ – kryetar 2.*****, Përgj. BNJ – anetar 3.*****, Specialist PTZHR – Anëtar 4.*****, Specialist PZHPA 5.*****, Specialist IBMK – Anëtar 6.*****, Specialist SHPEC- Anëtar	***** Specialiste BNJ	*****	*****@bujqesia.gov.al	Akt Nr.1453 prot., datë 19.2.2025
1	Agjencia per Zhvillim Bujqesor dhe Rural	Urdhër Nr.96, datë 14.2.2025	1.*****, Përgjegjës i BNJ – kryetar 2.*****, Specialist BNJ – Anëtar 3.*****, Specialist BNJ – Anëtar	***** Përgjegjës BNJ	*****	*****@azhbr.gov.al	Akt Nr.835/1 prot., datë 14.2.2025
2	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Shkoder	Urdhër Nr.14, datë 17.2.2025	1.*****, Drejtor – kryetar 2.*****, Specialist i BNJ – Anëtar 3.*****, Përgj. sektori – Anëtar 4.*****, Përgj finance Anëtar 5.*****, Përgj.sektori – Anëtar 6.*****, Përgj sektori – Anëtar 7.*****, Përgj. sektori - Anëtar	***** Specialiste arkiv-protokoll	*****	*****@arebshkoder.gov.al	Akt Nr.189/1 prot., datë 17.2.2025
3	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Lushnje	Urdhër Nr.94, datë 19.2.2025	Qendra Lushnje: 1.*****, kryetar 2.*****, Anëtar 3.*****, Anëtar SEB Fier: 1.*****, Anëtar 2.*****, Anëtar 3.*****, Anëtar SEB Vlorë: 1.*****, Anëtar 2.*****, Anëtar	*****	*****	*****@areblushnje.gov.al	Akt Nr.94/1 prot., datë 19.2.2025
4	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë	Urdhër Nr.18, datë 15.2.2025	Qendra Tiranë: 1.*****, Përgj. sektori – kryetar 2.*****, Përgj. sektori – Anëtar 3.*****, Specialiste BNJ – Anëtar SEB Tiranë: 1.*****, Përgj. sektori – kryetar 2.*****, Spec. Sektori – Anëtar 3.*****, Spec. Sektori – Anëtar SEB Durrës: 1.*****, Përgj. sektori – kryetar 2.*****, Specialist – Anëtar 3.*****, Specialist – Anëtar Seb Dibër: 1.*****, Spec. Sektori – kryetar 2.*****, Spec. Sektori – Anëtar 3.*****, Spec. Sektori – Anëtar	***** Specialiste BNJ	*****	*****@arebtirane.gov.al	Akt Nr.09/2, datë 15.2.2025
5	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Korçë	Urdhër Nr.4, datë 19.2.2025	1.*****, Përgj. e AREB Korçë, kryetar 2.*****, Përgj. AREB Elbasan, Anëtar 3.*****, Përgj. AREB Berat, Anëtar	***** Specialiste BNJ	*****	*****@arebkorce.gov.al	Akt Nr.75/1 prot., datë 19.2.2025
6	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushe-Kruje	Urdhër Nr.12, datë 17.2.2025	1.*****, Specialist finance – kryetar 2.*****,Sekretare – Anëtar 3.*****, Përgj. Sektori financës	***** sekretare	*****	*****@qttbfushekruje.gov.al	Akt Nr.133/1 prot., datë 17.2.2025
7	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje	Urdhër Nr.11, datë 14.2.2025	1.*****, Përgj. Sektori financës dhe SHM – kryetar 2.*****, Specialist finance – Anëtar 3.*****, Specialiste farërave - Anëtar	***** Specialist finance	*****	*****@qttblushnje.gov.al	Akt Nr.54 prot., datë 17.2.2025
8	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë	Urdhër Nr.19, datë 14.2.2025	1.*****, Përgj. sektori – kryetar 2.*****, Specialist – Anëtar 3.*****, Sekretar - Anëtar	***** Përgj. sektori	*****	*****@qttbvlora.gov.al	Akt Nr.73, datë 14.2.2025
9	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë	Urdhër Nr.16, datë 14.2.2025	1.*****, Dreejtor Drejtorie – kryetar 2.*****, Specialist frutikulture –Anëtar 3.*****, Specialist finance - Anëtar	***** Specialist frutikulture	*****	*****@qttbkorce.gov.al	Akt Nr.49 prot., datë 20.2.2025
10	Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqësore Shkodër	Urdhër Nr.5, datë 15.2.2025	1.*****, Drejtor - kryetar 2.*****, Përgjegjës Sekt. Farës - Anëtar 3.*****, Përgj. Sektori financës - Anëtar	***** Përgj. Sektori financës	*****	*****@qttbshkoder.gov.al	Akt Nr.5/1 prot., datë 21.2.2025
11	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve	Urdhër Nr.22/1, datë 14.2.2025	1.*****, Përgjegj. sektori – kryetar 2.*****, Specialist BNJ – Anëtar 3.*****, Drejtor finance - Anëtar	***** Drejtor finance	*****	*****@akvmb.gov.al	Akt Nr.228/1 prot., datë 14.2.2025
12	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë	Urdhër Nr.23, datë 21.2.2025	1.*****, Përgjegjës – Anëtar 2.*****, Përgj. Sektori veterinar Tiranë – Anëtar 3.*****, Përgj. Sektori veterinar Dibër – Anëtar 4.*****, Përgj. Sektori veterinar Durrës – Anëtar 5.*****, Specialist BNJ – Anëtar	***** Specialist BNJ	*****	*****@akvmb.gov.al	Akt Nr.153/1, datë 21.2.2025
13	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Shkodër	Urdhër Nr.9, datë 14.2.2025	1.*****, titullar – kryetar 2.*****, Specialist BNJ – Anëtar 3.*****, Përgj. Sekt. Veterinar Shkodër - Anëtar	***** Specialist BNJ	*****	*****@akvmb.gov.al	Akt Nr.109/1 prot., datë 14.2.2025
14	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan	Urdhër Nr.8, datë 14.2.2025	1.*****, përgj - kryetar 2.*****, Specialiste – Anëtar 3.*****, Spec. Veteriner - Anëtar	***** Specialist BNJ	*****	*****@akvmb.gov.al	Akt Nr.151/1 prot., datë 14.2.2025
15	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë	Urdhër Nr.201/1 prot., datë 17.2.2025	1.*****, Përgj. Sektori financës – kryetar 2.*****, Përgj. Sektori Veterinarisë Vlorë – Anëtar 3.*****, Përgj. Sektori Veterinarisë Gjirokastrë 4.*****, Përgj. Sektori Veterinarisë Fier – Anëtar 5.*****, Përgj. Sektori i Mbrojtjes Bimëve Vlorë - Anëtar	***** Specialist i BNJ	*****	*****@akvmb.gov.al	Akt Nr.1, datë 17.2.2025

16	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve	Urdhër Nr.12, datë 17.2.2025	1. ***** , Specialist për certifikimin – Anëtar 2. ***** , Specialist finance – Anëtar 3. ***** , Specialist për certifikimin – Anëtar	***** Specialist për certifikimin	*****	*****@eshff.gov.al	Akt Nr.96/1 prot., datë 17.2.205
17	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve	Urdhër Nr.6, datë 14.2.2025	1. ***** , përgjegjës sektori – kryetar 2. ***** , specialist – Anëtar 3. ***** , Specialist - anetar	***** Përgjegjës sektori	*****	*****@akdc.gov.al	Akt Nr.31/1 prot., datë 17.2.2025
